



Peleshi: Krenari dhe privilegj, FA-të janë vlerësuar në mënyrën më dinjitoze!

Shqipëria merr drejtimin e Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG). Drejtimi i SEEBRIG ndodh për herë të dytë, si pjesë e procesit të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore SEDM. "Krenari dhe privilegj që Forcat tona të Armatosura janë vlerësuar në mënyrën më dinjitoze në arenën ndërkombëtare", - do të shprehej Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me rastin e marrjes së drejtimit të SEEBRIG nga Shqipëria,

dhe nën komandën e gjeneral brigade Bilbil Bitrit, për një mandat trevjeçar, të dislokuar në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut.

"Suksese të përzemërta për gjeneral Bitrin, në këtë rrugëtim sfidues! Shpresëplotë që ai do vazhdojë të bëjë krenar vendin tonë dhe të përfaqësojë me dinjitet Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", - do të mbyllte urimin e tij ministri Peleshi. >>> faqe 2



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti ministren e Jashtme të Kanadasë, Mélanie Joly



>>> faqe 3

"Balkan Master Championship" shpall kampionë përfaqësues të FARSH

Ekipi i Forcave të Armatosura që mori pjesë në kampionatin "Balkan Master Championship" në Izmir, Turqi, arritën të shpallen kampionë në disa disiplina në atletikë, hedhje gjyle dhe kërcim së gjati. Major Bledar Mesi u shpall kampion në garën 3000 m me pengesa, i dyti në 800 metra dhe i pari në garën 400 m me pengesa. Major Gernat Qirici kampion në disiplinën e 400 metrave me pengesa. Major Ervin Hysi, u shpall kampion në disiplinën e kërcimit së gjati...



>>> Faqe 2

Komandanti i Forcës Detare priti në takim kortezie Atasheun Ushtarak të Turqisë

Në Komandën e Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, priti në një takim kortezie, Atasheun Ushtarak të Turqisë për Shqipërinë, kolonel Muhamet Kelami Kablay. Kundëradmiral Agastra e falënderoi Atasheun për bashkëpunimin dhe mbështetjen e madhe që ka dhënë pala turke për Forcën Detare dhe në veçanti anijes tonë përfaqësuese në mision në detin Egje. Atasheu turk falënderoi gjithashtu, për bashkëpunimin shumë të ngushtë dhe të suksesshëm ndërmjet dy Forcave, si dhe klimën e ngrohtë...



>>> Faqe 4

Kolonel Gjon Vorfi - ushtaraku madhor që shërbeu denjësisht në Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit

Në rrënjët e oxhakut "Vorfi". Është Ne njohur shprehja "Bëmë baba të të ngjaj". Shembullin e babait për atdhetari dhe përkushtim ndaj Atdheut, e ndoqi edhe i biri, Gjon Vorfi që në fëmijëri dhe përgjatë gjithë rrugëtimit jetësor. Gjon Preng Vorfi është lindur, më datën 27 gusht 1958, në Sukagji të Lezhës, në një ambient fisnik atdhetar, oxhakun e të cilëve nuk e kishin përkulur pushtimet dhe rrebeshet e kohës. Babai i Gjonit, Preng Pjetër Vorfi kishte lindur më 1920 në Sukagji, fshat i Lezhës me rreth 150 shtëpi. U përball me sfidat e jetës duke i dalë krah...



>>> Faqe 14



Shqipëria merr drejtimin e Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG).

Drejtimi i SEEBRIG ndodh për herë të dytë, si pjesë e procesit të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore SEDM.

“Krenari dhe privilegj që Forcat tona të Armatosura janë vlerësuar në mënyrën më dinjitoze në arenën ndërkombëtare”, - do të shprehej Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me rastin e marrjes së drejtimit të SEEBRIG nga Shqipëria, dhe nën komandën e gjeneral brigade Bilbil Bitrit, për një mandat trevjeçar, të dislokuar në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut.

“Suksese të përzmërta për gjeneral Bitrin, në këtë rrugëtim sfidues!

Shpresëplotë që ai do vazhdojë të bëjë krenar vendin tonë dhe të përfaqësojë me dinjitet Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, - do të mbyllte urimin e tij ministri Peleshi.



Peleshi: Krenari dhe privilegj, FA-të janë vlerësuar në mënyrën më dinjitoze!

“Balkan Master Championship” shpall kampionë përfaqësues të FARSH

Ekipi i Forcave të Armatosura që mori pjesë në kampionatin “Balkan Master Championship” në Izmir, Turqi, arritën të shpallen kampionë në disa disiplina në atletikë, hedhje gjyle dhe kërcim së gjati.

Major Bledar Mesi u shpall kampion në garën 3000 m me pengesa, i dyti në 800 metra dhe i pari në garën 400 m me pengesa.

Major Gernat Qirici kampion në disiplinën e 400 metrave me pengesa.

Major Ervin Hysi, u shpall kampion në disiplinën e kërcimit së gjati.

Major Edison Kaja u shpall kampion në hedhje gjyle. Mirënjohje për të gjithë efektivat tanë që ngrenë lart Flamurin Kombëtar dhe sa më shumë suksese në aktivitetet e ardhshme.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti ministren e Jashtme të Kanadasë, Mélanie Joly

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi priti në një takim zyrtar ministren e Jashtme kanadeze, znj. Mélanie Joly. Takimi ishte i një rëndësie të veçantë, pasi si dy vende anëtare të NATO-s, të dy ministrat diskutuan çështje të ndryshme të bashkëpunimit dhe rolin e kontributin e veçantë të Kanadasë në Ballkanin Perëndimor.

Ministri shprehu mirënjohjen e tij për gjithë mbështetjen që Kanada ja i ka dhënë dhe i jep Shqipërisë, por mbi të gjitha për mbështetjen e jashtëzakonshme që kontingjenti kanadez, i cili kryeson misionin e NATO-s "Enhanced Forward Presence", i jep togës EOD shqiptare të dislokuar në Kamp Adazi të Letonisë.

Nga ana e saj, ministrja e Jashtme e Kanadasë, znj. Mélanie Joly, falënderoi për mikpritjen ministrin Peleshi dhe shprehu gatishmërinë për intensifikimin e këtij bashkëpunimi në kuadër të Aleancës.

Ministrja Joly u ndal në rëndësinë e mbështetjes së Ballkanit Perëndimor, sfidat e sigurisë me të cilat përballet sot e gjithë bota, si për nevojën për të shtuar mbështetjen ndaj vendeve demokratike që përballen ose mund të përballen me ndërhyrje apo fushatat e dizinformimit nga ana e Rusisë.

Ministrat rikonfirmuan vendosmërinë e tyre për të vijuar kontributin në sigurinë ndërkombëtare, duke përfshirë mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën, si dhe forcimin e lidhjeve diplomatike dhe bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kanadasë.



MINISTRI SHPREHU MIRËNJOHJEN E TIJ PËR GJITHË MBËSHTETJEN QË KANADAJA I KA DHËNË DHE I JEP SHQIPËRISË, POR MBI TË GJITHA PËR MBËSHTETJEN E JASHTËZAKONSHME QË KONTINGJENTI KANADEZ, I CILI KRYESON MISIONIN E NATO-S "ENHANCED FORWARD PRESENCE", I JEP TOGËS EOD SHQIPTARE TË DISLOKUAR NË KAMP ADAZI TË LETONISË.



Përfundon me sukses stërvitja speciale e efektivëve të Batalionit të dytë të Këmbërorisë, nën suportin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer të ekipit të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë Amerikane.



Komandanti i Forcës Ajrore priti Atasheun Ushtarak të Turqisë

Në ambientet e Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, priti në një takim kortezie, Atasheun Ushtarak të Turqisë për Shqipërinë, kolonel Muhamet Kelami Kablay dhe zëvendës Atasheun, kapiten Celal Tekin. Gjeneral Pulaj, e falënderoi Atasheun për kontributet që Turqia ka dhënë për Forcën Ajrore. Gjithashtu, gjatë takimit u diskutua krijimi i kapaciteteve fillestare operacionale për përdorimin e dronëve. Në përfundim të takimit, gjeneral Pulaj, falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore dhe i uroi suksese të mëtejshme në detyrë, duke e siguruar se bashkëpunimi do të vazhdojë dhe në të ardhmen.



Komandanti i Forcës Detare priti në takim kortezie Atasheun Ushtarak të Turqisë

Në Komandën e Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, priti në një takim kortezie, Atasheun Ushtarak të Turqisë për Shqipërinë, kolonel Muhamet Kelami Kablay. Kundëradmiral Agastra e falënderoi Atasheun për bashkëpunimin dhe mbështetjen e madhe që ka dhënë pala turke për Forcën Detare dhe në veçanti anijes tonë përfaqësuese në mision në detin Egje. Atasheu turk falënderoi gjithashtu, për bashkëpunimin shumë të ngushtë dhe të suksesshëm ndërmjet dy forcave, si dhe klimën e ngrohtë dhe miqësore që ka gjetur në Shqipëri, duke u shprehur se e njëjta frymë miqësore do të ndiqet dhe nga pasardhësi i tij. Në përfundim të takimit, kundëradmiral Agastra, falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Detare dhe i uroi suksese në detyrat e mëtejshme.



Efektivët shqiptarë përfundojnë me sukses misionin në Greqinë e goditur nga zjarret

Efektivët shqiptarë përfundojnë me sukses misionin në Greqinë e goditur nga zjarret masive. Ekipi, i përbërë nga punonjës të specializuar të emergjencave civile dhe bashkive të Korçës dhe Maliqit, u angazhua në operacionet e ndihmës për shuarjen e zjarreve në Greqi dhe tashmë kthehet në atdhe me vetëdijen e detyrës të plotësuar si dhe me ndjenjën e krenarisë për kontributin e tyre në ndihmën e popullit mik grek në kohë të vështira.



Rrugëtimi i Hilë Lushakut, nga uniforma ushtarake në atë të Policisë të Shtetit

Hilë Lushaku u lind në Burrel, më 6 janar 1954, i diplomuar “Oficer zbulimi” dhe “oficer policie”, u arsimua në shkollën 8-vjeçare “Gjon Doku”, në Ballë, Lezhë, të cilën e përfundoi me rezultate shumë të mira. Ndoqi studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë, të cilat i përfundoi me rezultatin “Shumë Mirë”, 1973-1976, vazhdoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, Tiranë, mori Diplomë, me rezultatin “Shkëlqyer”, më pas kreu studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Tiranë, mori Diplomë, me rezultatin “Shkëlqyer”, pa shkëputje nga puna kreu studimet në Akademinë e Policisë, Tiranë. Në kohën e rivendosjes së gradave, më 1991, mori gradën e parë ushtarake “major”, më pas mori gradën “nënkolonel” dhe në fundin e vitit 1994 mori gradën “kolonel”, për vlerësimet e larta që mori në drejtimin e repartit special të Policisë “Renea”, në kapjen e personave kriminelë, cilësuar “me rrezikshmëri të lartë për sigurinë në vend”. Gradën Policore “komisar”, implementuar në vitin 2003.

Ka mbajtur funksione të ndryshme si në: Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kryespecialist në Shërbimin e Inspektimit e Auditimit; Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kryespecialist në Sektorin e Analizës Strategjike; në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, shef i Sektorit të Planifikim-Koordinimit të Operacioneve në Drejtorinë Qendrore të Forcave Speciale dhe të Ndërhyrjes së Shpejtë, në Kryeministri, Ndihmës i Kryeministrit për Sigurinë Kombëtare, Rendin, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin Informativ të Shtetit, në Gardën e Republikës, komandant i Repartit nr. 410, Mullet, në Ministrinë e Rendit Publik, drejtor i Drejtorisë së Forcave Speciale e të Ndërhyrjes së Shpejtë, kryetar i Degës së Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe i komanduar Drejtor i Forcave & Ndërhyrjes së Shpejtë, Inspektor i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, komandant i Repartit Special të Policisë RENEJA; në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, Drejtorja e Zbulimit, oficer Drejtimi i Zbulimit Ushtarak me Trupa, komandant i Batalionit të Zbulimit, Divizioni Këmbësisor në Shijak, Pedagog në Shkollën e Zbulimit Ushtarak, Tiranë, komandant i kompanisë së mbrojtjes së Aerodromit Ushtarak të Gjadrit, në Lezhë, komandant toge, oficer stazhier në Bratosh, Veleçik, Malësi e Madhe. Njohës i mirë i gjuhës bullgare, serbo-kroate, dhe angleze.

Anëtar i Këshillit Shkencor i Drejtorisë së Zbulimit në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore; Anëtar i jashtëm i Katedrës së Zbulimit dhe të Ushtrive të Huaja në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ka kryer kurs specializimi njëmuor në Policinë austriake dhe në Forcat Speciale “GEK-KOBRA”, Vjenë, Austri; Kurs specializimi njëmuor në Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë (SRC-Kompanitë e Sigurimit Republikan) në Dizhon, Lion, Paris, Bordo të Francës, kurs specializimi njëmuor në Forcat Speciale dhe në Policinë e Parisit, Francë, tre kurse kualifikimi me specialistë amerikanë



për luftën kundër terrorizmit dhe për çlirimin e pengjeve, Tiranë.

Publikime

“Fjalor terminologjik i zbulimit ushtarak” (bashkautor); “Rregullore e nënrepartëve të zbulimit në luftim” (bashkautor); Skenar i filmit dokumentar televiziv “Zbuluesit në stërvitje”; Libri bibliografik “I Përjetshmi Arben Ujka”, kushtuar policit dëshmor të Forcave Speciale; Libri “Teknikat profesionale të ndërhyrjeve”, bashkautor dhe kryeredaktor. “Rregullore e Drejtorisë së Forcave Speciale dhe të Ndërhyrjes së Shpejtë”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik nr.678, datë 13.05.1998; “Rregullore e pranimit dhe e qëndrimit në FS&NSH”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik nr. 764, datë 4.08.1998; Akti normativ, “Metodika e futjes

në veprim të FS&NSH dhe rekomandime për planifikimet operacionale”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik nr.762, datë 03.08.1998; Akti normativ, “Për ruajtjen e garantimin e fshehtësisë së identitetit personal të FS&NSH”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik nr. 774, datë 20.08.1998; Akti normativ, “Mbi mënyrën e përdorimit të FS&NSH në ndërhyrjet operacionale”, miratuar me urdhër të Ministrit të Rendit Publik nr. 181, datë 10.03.1999; Studim, “Gjendja e Forcave Speciale e atyre të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe detyrat për riorganizimin e konsolidimin e reparateve në këto struktura”, Skenar i demonstrimit policor dhe autor i tekstit të komentit në radiotelevizion, në 90-vjetorin e krenimit të ditës së krijimit të Policisë së Shtetit, transmetuar drejtpërdrejt në Televizionin Shtetëror, më 13 janar.

Akti normativ, Udhëzim nr. 1879, datë 11.07.2003 “Për aktivizimin në shërbim dhe mënyrën e veprimeve në ndërhyrje të njësisë speciale të negociimit; Akti normativ, Udhëzim nr. 1880, datë 14.07.2003 “Për aktivizimin në shërbim dhe mënyrën e veprimeve në ndërhyrje të njësisë speciale të antiexpozivitetit”; Akti normativ, Udhëzim nr. 1875, datë 10.07.2003 “Për përdorimin në shërbim dhe mënyrën e veprimeve të ekuipazhit të njësisë speciale të helikopterëve”.

Dekoruar dy herë me Medaljen e Shërbimit Ushtarak me motivacionin “Për rezultate të shkëlqyera në përgatitjen e Forcave Speciale”, kur ishte në Forcat e Armatosura (në Ministrinë e Mbrojtjes) dhe me Medaljen “Për Shërbime të Veçanta në kryerjen e detyrës”.

Nga kolana “Skënderbegasit ndër vite”



HILË LUSHAKU
ËSHTË DEKORUAR
DY HERË ME
MEDALJEN
E SHËRBIMIT
USHTARAK ME
MOTIVACIONIN
“PËR REZULTATE
TË SHKËLQYERA
NË PËRGATITJEN
E FORCAVE
SPECIALE”, KUR
ISHTË NË FORCAT
E ARMATOSURA
(NË MINISTRINË E
MBROJTJES) DHE
ME MEDALJEN
“PËR SHËRBIME
TË VEÇANTA
NË KRYERJEN E
DETYRËS”.



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

6 betejat e humbura dhe fundi turpërues i luftës së Ruisë "Putiniste"

Në kapacitetin e ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s, kam vijuar të ndjek me interes të shtuar mbi 550 ditë luftime të përgjakshme në fushëbetëjen në Ukrainë. Në njëjtën kohë kam publikuar disa 10-ra vlerësime strategjike jo vetëm në median brenda dhe jashtë vendit, por edhe me kolegë e personalitete të sigurisë në konferenca dhe panele diskutimi të Këshillit të Atlantikut dhe Institutit të Luftës në Uashington; Bruksel, Qendrën Marshall, Gjermani, Londër, Paris, Sofje, Prishtinë, Kolegjin e NATO-s Romë, etj.

Nga ana tjetër, pa pretenduar kurrsesi të "privatizoj të vërtetën shteruese" kam refuzuar me vetëdije të bëhem pjesë e "tallavasë egocentrike", pasi, kurrsesi nuk kam kohë të shpërdoroj me shterpësinë e mendimit të "kuvendarëve të emëruar"; dalldisjet e analistëve të gjithëditur dhe rambo-sekserëve të vetë-(de) graduar "gjenral", që turfullojnë nëpër banaqe mediatike për skenarë, avionë, tanke, trashe, "bunkerë atomik, rezerva strategjike dhe ditët e qametit", duke e shpjeguar kështu, "luftën jo vetëm për Ukrainën" me konceptet e Luftës së Dytë Botërore; të luftës së ftohtë, fushatave të Carit, në mos të kohës së gurit!

Po ashtu, pas 18 muajsh do duhet të risjell në vetëdijen publike, se udhëheqës të deformuar nga paranojat e pushtetit dhe nostalgjik të "lavdisë së ushtrisë së kuqe" në Kremlin dhe jo vetëm; politikanë të korruptuar dhe kamikazë anti-perëndimorë si dhe sekserë të interesave të oligarkisë (përfshi në Shqipëri), e mbivlerësuan fuqinë ushtarake të Ruisë me peshoren tradicionale: numër tankesh; (Mig/29 pothuaj ekuivalent me F-35); numër mbushjesh/armë bërthamore, strategji mëndje-ndryshkur, etj. Për pasojë parashikuan skenarin më ogurzi: "në mos punë javësh, maksimumi 3 muaj Rusia do ta celebronte me lule, këngë dhe valle fitoren e lavdishme të pushtimit të Ukrainës si dhe triumfin ndaj NATO/BE.

Por falë gjakut, rezistencës heroike të Ukrainës martire si dhe mbështetjes së pakushtëzuar të Aleancës Euro-Atlantike, asgjë nga këto nuk ndodhi.

Për ta thënë edhe më qartë, në vijim po paraqes: "6 betejat e humbura si dhe fundin turpërues të Luftës që e pret Ruisë 'Putiniste'":

Beteja e humbur 1: Ka dështuar në qëllimin për të pushtuar për 3 muaj Ukrainën (as me tanke dhe raketa as me lule dhe valle), as deri më 9 maj 2022, as mbas 18 muajsh, as nuk e ka për ta zhvilluar kurrë paradën e fitores madhështore në Kiev. Pra, nuk ka mbetur më asnjë pikëpyetje, madje as në Kremlin, që e ka humbur këtë betejë/objektiv strategjik.

Në të kundërt, mbas më shumë se 18 muajsh, jo vetëm që nuk ka arritur këtë objektiv, por është futur i rraskapitur në llogoret e Zaporizhia, Oblast, Klishchiivka, Bakhmut, etj., duke lënë në fushëbetëje: "rreth 30% të territoreve të pushtuara dhe të shpallura me referendume si pjesë të Mëmës-Rusi; 250 mijë të vrarë; më shumë se 5 trilion euro kosto e luftës, ose mbi 3 herë më shumë se Prodhimi i Përgjithshëm Neto i Ruisë (1.8 trilion euro për 2022); duke rrënuar kështu rëndë moralin e ushtrisë!"

Nga ana tjetër, duhet theksuar edhe më qartë se pavarësisht fushatave të dëshpëruara si shtet terrorist ndaj popullsisë civile, Spitaleve,



Hidrocentraleve, tubacionit ndërkombëtar të amoniakut; avantazheve nga mbrojtja në bunkerë/transhe për të penguar kundëroffensivën e Ukrainës, Rusia ka dështuar jo vetëm për të arritur këtë objektiv strategjik (pushtimin), por bashkë me të ka humbur edhe iniciativën strategjike dhe epërsinë operacionale në fushëbetëje.

Beteja e humbur 2: Rusia e ka humbur betejën për të sfiduar fuqinë ushtarake të NATO-s, si dhe për të kërcënuar kufijtë, interesat dhe vlerat Euro-Atlantike.

Në të kundërt, lufta jo vetëm e forcoi solidaritetin/mbështetjen për Ukrainën dhe kohezionin mes vendeve të NATO-s, por edhe i zgjeroi kufijtë e Aleancës.

Më konkretisht, NATO u zgjerua me Finlandën dhe së shpejti me Suedinë, pra arriti në 32 ose 2-fishin e vendeve që trashëgoi nga lufta e ftohtë (16 vende deri në 1990), ndërsa statusi i Ukrainës në Samitin e fundit në Lisbonë, u ri-konfirmua, pra u rrit në nivelin e "Komitetit NATO - Ukrainë" ose e thënë ndryshe më afër së kurrë pranë anëtarësimit.

Mbas 550 ditësh luftimesh të përgjakshme është vërtetuar, (ndoshta me 2-3 përjashtime nga aktorë kontrovers pa intuitë strategjike), se Rusia "Putiniste" e ka humbur po ashtu betejën dhe shpresat për të minuar kohezionin mes NATO-s dhe BE-së, duke përdorur "gazin si armë gjeopolitike" apo duke kërcënuar (si shtet terrorist) me fuqinë bërthamore!

Në planin e mbështetjes ushtarake, deri aktualisht në terren kanë mbërritur mbi 95 % e paketës së armatimeve të gjeneratës së fundit nga SHBA, MB, Gjermania dhe nga pothuaj të gjitha vendet e NATO-s (tanke "Abrams", "Challenger", "Leopard", sistemeve "Patriot", dronë "Bajraktar", avionë dhe helikopterë

luftimi, municione artilerie, etj.), si garanci për të mbështetur kundërmësymjen e fitores së merituar të Ukrainasve, por dhe të mbështetur dhe të bekuar nga Perëndimi.

Beteja e humbur 3: Është vetë-diskredituar dhe ka humbur betejën për të tronditur rendin dhe mekanizmat e sigurisë globale.

Që në krye të herës, por edhe në mbi 18 muaj luftime, vërtetuan se agresioni ushtarak i Ruisë "Putiniste", nuk ishte vetëm kundër sovranitetit të Ukrainës por edhe: "kërcënim serioz ndaj rendit global të sigurisë, kufijve të demokracisë, si dhe ndaj interesave dhe vlerave Trans-atlantike (USA/UN/UK/NATO/BE)".

Në të kundërt, Rusia "Putiniste" gjendet sot më e izoluar dhe më e diskredituar se asnjëherë më parë në historinë e saj. Nga 195 (përfshi Kosovën) vetëm 4 shtete (Koreja e Kim-Jongut dhe 3 shtete terroriste të Afrikës) e njohën këtë aventure neo-naziste. Po për shkak të kësaj lufte rrezikon potencialisht përjashtimin nga 5-shja vendimmarrëse e Këshillit të Sigurimit/OKB si dhe është lëshuar nga Gjykata Ndërkombëtare "urdhër arresti për krime lufte" ndaj Putinit dhe më tej për listën e gjeneralëve dhe oborrtarëve zullumqare rreth tij.

Beteja e humbur 4: Jo vetëm është "zhgënjyer" por ka mbetur e turpëruar për të tërhequr Pekinin zyrtar në një aventurë gjeostrategjike si dhe përfshirë Kinën në hapjen e një fronti të ri lufte ndaj Taivanit, dhe ndoshta jo vetëm.

Në të kundërt, që në fillim të kësaj ndërmarrjeje kriminale (shkurt 2022), edhe pse Kina ishte kundër sanksioneve ndaj Ruisë, me qetësinë tipike Aziatike mori refuzimin diplomatik të Pekinit (Ambasadori i Kinës në OKB e quajti Luftë këtë rast).

Po ashtu, është fakt që në 18 muaj, Kina nuk i ka dhënë asnjë premtim dhe as mbështetje me

programe dhe armatime ushtarake Ruisë, si dhe së fundmi e paralajmëroi fort Moskën Zyrtare për mos-vendosjen e armëve bërthamore në Bjellorusi, etj.

Kështu, dështuan me turp llogaritë dhe zvarritja djallëzore e pinjollit të KGB-së (Putinit), dhe bashkë me të, "oborrtarët e diplomacisë dhe gjeneralët e lemerisur" nga Putini, të cilët nga "deliri i fitores së padiskutueshme" as nuk e kishin konsideruar që "Kina nuk bën lojën e askujt kur vjen fjala për interesa gjeostrategjike dhe gjeopolitike, por edhe nuk mund të jetë kurrsesi aleate e natyrshme me Ruisë në luftën kundër SHBA-së dhe BE-së".

Beteja e humbur nr.5: Me gjithë perden e hekurt staliniste, Putinistët e kanë humbur edhe betejën për të mbajtur kohezionin dhe krenarinë perandorake të kombit Rus.

Në të kundërt, 250 mijë të vrarë në fushëbetëje; më shumë se 5 trilionë € kosto 550 ditë/natë lufte, ose mbi 3 herë më shumë se Prodhimi i Përgjithshëm Neto i Ruisë (2022 = 1.8 trilionë €); ka leqendisur jo vetëm moralin e ushtrisë, epërsinë operacionale, iniciativën strategjike por edhe rolin dhe peshën gjeopolitike të kombit Rus.

Ndoshta për "meritë të armës bolshevike të desinformimit" është krijuar një mjegullnajë rreth shpërdorimit (si limon i shtrydhur) të mercenarit/terrorist të salsiçeve (Prigozhin), 4 si ndër përpjekjet djallëzore të Putinit për të rikuperuar kohezionin e kombit si dhe moralin e rrënuar të ushtrisë. Nga ana tjetër, Moska premtonte se do të rekrutojë edhe 420 mijë rezervistë për në vijën e transheve/frontit deri në fundin e vitit, ose në palcën e dimrit 2023.

Beteja e humbur nr.6: E përsëris se fatmirësisht Rusia "Putiniste" jo vetëm ka humbur edhe betejën për të ndezur një front të ri lufte, duke frymëzuar grupet kriminale, axhendën e politikanëve të korruptuar si dhe ekstremistët e tipit Dodik në Ballkan, apo për të ricikluar oscilacionet e Beogradit zyrtar, duke kërcënuar "deri me agresion ushtarak nën inspektimin e Ambasadorit Rus në Serbi...", jo vetëm kundër sovranitetit territorial të Kosovës, por edhe kundër prezencës së NATO/KFOR-it me mision atje...?

Në përmbyllje e përsëris edhe më fort, se dështimet në 6 betejat e sipërpërmendura janë vetëm fillimi i rrokullimës drejt humbjes turpëruese të luftës që e pret Ruisë "Putiniste".

Konsideruar në këto, jam i bindur se, bashkë me humbjen turpëruese të Luftës për pushtimin e tërësisë territoriale të një vendi sovran/Ukrainës, Rusia do të diskreditohet për rolin dhe peshën gjeopolitike në Botë, përfshi Ballkanin perëndimor.

Në shtesë, në cilësinë e ekspertit të sigurisë kombëtare, do t'i këshilloja faktorët me peshë politike si dhe aktorët shtetërorë të Tiranës Zyrtare që: "humbja turpëruese e luftës, kolapsi ekonomik dhe diskreditimi ndërkombëtar, përfshi në Ballkan, që e pret Ruisë "Putiniste", mbetet një rrethanë e favorshme gjeopolitike në dobi të faktorizimit të RSH-së në tavolinat e vendimmarrjeve të mëdha (SHBA/NATO/UN) si dhe për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat mbarëkombëtare në Rajon, Mesdhe, etj.!"

Metropoli hyjnor me emrin "Nënë Tereza"

Nga goja e Nënë Terezës dolën aq shumë fjalë të urta, sa do të mund të shkruheshin libra me to! Fjalë fluturake, që ajo vetë nuk kishte kohë t'i shkruante, sepse kohën e shfrytëzonte për t'i dhuruar jetë, atyre që nuk e dinin ç' është jeta. S' kish kohë për të shkruar libra, e megjithatë la pas aq histori, sa të frymëzojë jo një njeri, po mbarë njerëzimin.

Karizmatike dhe e guximshme, Nënë Tereza udhëtoi vazhdimisht për t'i ndihmuar njerëzit që fati a dora e njeriut i kish flakur në mes të rrugëve të botës. Njerëz që kërkonin pikërisht një Nënë Terezë për t'i prirë kur bëheshin gati të niseshin nga kjo botë, drejt qiellit, duke i shpëtuar me trup e me shpirt!

E ndërsa vijonte shtegtimin e pafundmë në rrugët e mjerimit, shqiptoi fraza, që bëjnë historinë. Thënë shpesh para skenave të tmerrshme, ku gjithkush mund të tmerrohej, veç saj!

Edhe këto e bënë të njohur Nënë Terezën e Kalkutës (1910-1997) në mbarë botën, si misionare e madhe shqiptare, që diti ta vlerësojë dinjitetin e çdo njeriu!

SHENJTËRIMI I NËNË TEREZËS

Më 5 shtator, Nënë Tereza u shpall e Shenjtë. Të kujtosh Shenjtoren Nënë Tereza i ngjan një misioni. Kujtimi më i mirë për Atë, është të vepruarit sipas porosive të Saj.

Nënë Tereza thoshte se, ajo që bëjmë ne, është një pikë uji në oqean, por oqeani prej pikash të tilla bëhet. Rëndësi ka, thoshte ajo, që edhe gjërat e vogla t'i bësh me dashuri të madhe. Madje dhe "të duash me dashuri", porosiste mrekullisht.

Dhe të flasësh për atë mbimadhësi oqeanike të shpirtit të saj dhe të bëmave të saj, e di që është vetëm një pikë uji.

Papa Françesku ngulmon që të mos përqendrohet puna dhe përkushtimi vetëm te metropolet, por te rrethinat së pari, te jeta në rrethinë, te kisha në rrethinë, te njeriu në rrethinë. Tashmë është dhe metropoli hyjnor me emrin "Nënë Tereza", por dhe ajo e nisi nga rrethina dhe shkoi më larg dhe më përtej, te mjerimi. Dhe pastaj nga plagët te yjet. Prandaj mund të flasësh dhe nga rrethina... tekta kupton nga kumtet e saj që, sa më shumë liri të fitosh, aq më shumë duhet të mbushesh me "Nënë Terezë", sa më i fortë të bëhesh, aq më shumë të mbushesh me dobësinë e Saj, forca ime është dobësia ime, thoshte Ajo, dhe kur dobësohesh, te ajo të gjesh forcë, sa më shumë të të pengojnë e nëpërkëmbnin, gjë që sot është kthyer në përditshmëri, aq më shumë të përftosh mëshirë "Nënë Tereze", faljen e Saj.

Shumë pyetje i drejtoheshin misionares shqiptare, dhe ajo me përunjësi i përgjigjej kujtdo që tregonte interes për punën e saj, por ajo që e bënte fytyrën e saj hijerëndë, madje edhe paksa të pikëlluar, ishte pyetja: "Si e ndieni veten në mesin e popullit tuaj...?"

Përgjigja: "Jam shumë e lumtur... Mendoj në veçanti për familjen time, për babanë tim të ndjerë, Kolën, dhe nënën time, Drane, që tani jeton me motrën time Age, në Tiranë, si dhe për vëllain tim, Lazrin, i cili jeton në Palermo... Nuk e kam parë nënën dhe motrën time që nga vitit 1928, që nga nisja ime..."

Babanë e Nënë Terezës e kishin helmuar si veprimtar shqiptar, tekta kthehej nga një mbledhje në Beograd, ai ishte nga Prizreni, tregtar që merrej dhe me kulturë, ishte pjesëtar në bandën muzikore të qytetit, themelues i teatrit në Shkup, etj., kurse nëna ishte nga Gjakova. Nënë Tereza 18 vjeçe iku nga shtëpia dhe u bë murgeshë, shkoi t'u shërbejë më të varfërve të të varfërve nëpër botë dhe u bë kështu "gruaja më e njohur e planetit". Veç me dashurinë e saj...



Bota po mrekullohej me Nënë Terezën. E ftonin, e mbështesnin, i jepnin dekorata, shpërblime, që i pranonte nëse ato do t'u shërbenin "fukarave të saj", siç e thoshte ajo vetë. Dhe Çmimin më lartë "Nobel për Paqe" prandaj e pranoi.

NGA CEREMONIA E NOBELIT...

Një ngjarje domethënëse një ditë para ceremonisë së madhe në Oslo, në Norvegji. Teksa nëpër rrugë endeshin mijëra e mijëra njerëz me pishtarë drite në duar, përflakeshin xhamat, dyndeshin te hoteli ku kishte bujtur Nënë Tereza, kudo ku mund të ishte ajo, donin që ta shikonin, Mbreti i Norvegjisë, Ollavi V do t'i thoshte Asaj:

- ...Po sikur të mos vij nesër në ceremoni?
- E pse? - ia ktheu Nënë Tereza shkujdesshëm.
- Që të mos jem unë në qendër të vëmendjes, kishte buzëqeshur mbreti.
- E ke gabim, në qendër s'jam as ti, as unë, e ndërpreu Nënë Tereza, - por Zoti...

Mbretërve, presidentëve, sundimtarëve, kujtdo Nënë Tereza guxonte, duke mos e ndërre si guxim, t'u drejtohej secilit me "ti". Ajo besonte te natyrshmëria, te vlera dhe barazia, që Zoti i ka dhënë gjithsecilit, vetvetja është e mjaftë dhe duke patur Zotin brenda vetes, secili nga ne është qendra dhe "uni" më i mirë, - sipas Nënë Terezës, - është tjetri. Kush jeni ju? Ishte për të mbajtur frymën dhe të dëgjoje

ç'do të thoshte botërisht Nënë Tereza: "Origjina ime është shqiptare... Unë jam katolike, murgeshë e kushtuar. Për nga thirrja ime, unë i takoj tërë botës. Por zemra ime i takon tërësisht Zembrës së Jezusit".

Ballkani ynë, fqinjët tanë shquhen për konflikte kësisoj, për përvetësime të historisë dhe heronjve të saj. Mesitari i përunjur shqiptar i dha fletën e bardhë Nënës dhe ajo shkroi me atë shkrimin e saj të bukur e të rregullt si rilindasit, ku kuptohet se kemi të bëjmë me një person të kultivuar që shkruan, fjalëpakë, por rreptësisht saktë, me ato shkronjat harmonike si kokrrat e rruzazës dhe ja, ç'na la:

"Unë gjithmonë e kam në zemër popullin tem shqiptar. Shumë luti Zotin që Paqja e Tij të vij në zemrat tona, në gjitha familjet tona, në gjithë botën. Lutem shumë për fukarat e mij, dhe për mua dhe motrat e mijja. Unë lutem për juve", - M. Teresa Bojaxhiu.

E mrekullueshme! E noterizuar për përherë. Pikërisht kjo letër e thjeshtë, gati si e rastësishme, ku do të vinte dhe mbiemrin e saj të familjes, i njohur ndër shqiptarë, duket se do të ndihmonte biografët dhe akademikët, do të hidhte dritë mbi hulumtimet e një të vërtete, do t'u mbyllte gojën debateve të mëvonshme për përkatësinë, paradigmeve të rrëmbimeve ballkanike, etj. Natyrisht fakte të tilla më shumë se sa Shenjtes, do të na duheshin ne, se atdheu i Nënë Terezës janë plagët e njeriut dhe ajo vetë është universale,

është quajtur Ungjill i gjallë, Pena e Zotit, Investitore e mëshirës, e dashurisë dhe e buzëqeshjes dhe s'i kishte parësore shqetësime të tilla tonat bjerrakohëse, por ne, mes këtij universi të shqetësuar, ku shpesh të vegjlit, duke nënkuptuar dhe popuj, harrohen, nëpërkëmben apo humbin, mund t'i themi kujtdo, duke përftuar, edhe me njohje ekzistenciale, dinjitet, se jemi një popull që dhuron shenjtë.

ARDHJA NË ATDHE

Dhe Shenjtja mundi të vijë në atdheun e saj 10 vjet pas marrjes së çmimit Nobel, në 1989.

"Ndihmojeni popullin tim!"

Nënë Tereza ishte kundër çdo lloj lufte, por tokësorët, që të ndalin luftërat e padrejta, shtrëngohen të bëjnë një luftë të drejtë, por lufta gjithmonë është e rëndë, tragjike, një vështirësi e hatashme dhe hatarat nuk janë të drejta.

...Kur shekulli i Nënë Terezës përplotësonte statistikën e prodhimeve, çelikut, ushqimit, makinat, etj., udhëtimet në kozmos, luftërat botërore, rajonale, të brendshme, civile, etj., të rënë, ajo, Nënë Tereza, llogariste buzëqeshjet, luftonte që të shtoheshin, me të vetmen armë, dashurinë e saj. Ky ishte shqetësimi i shtëpive të saj të bamirësisë. Si një sfidante hyjnore, ajo u quajt nëpër metropole si "industrialistja më e madhe e mëshirës".

Për vite me radhë, teologë, shkencëtarë, sociologë, mjekë, dëshmitarë të ndryshëm nga bota mbushën dosjet me prova të mrekullive të Nënë Terezës, se si ajo u kthente buzëqeshjen dhe atyre që nuk kishin buzëqeshur kurrë, se si i ringjallte kufomat e rrugëve, se si u bë "investitorja e dashurisë botërore".

U ndje për shenjtëreshë qysh në gjallje, pritej shpallja.

5 SHTATORI I SHENJTË...

Dhe ashtu u bë. Ndodhi më 5 shtator. Sa dritë kishte ajo ditë!

Po a fronte dita e kanonizimit. Në një nga dritaret e përfaqësisë, në katin e dytë të një pallati të vjetër në Rrugën "Ottaviano" 43, vunë një portret të madh të Nënë Terezës, që dukej sikur e qeshura e saj e bënte më të ëmbël ajrin dhe turistët e shumë ndalnin, e fotografonin dhe vazhdonin në turma të shkonin për te sheshi më i bukur i të gjithë botës katolike, para bazilikës "San Pietro".

Nënë Tereza rrëzëllente nga shenjtëria!



Nora e Kelmendit, gruaja e fuqishme, shndërruar në legjendë

Historia e shek. XVII për Norën e Kelmendit tashmë është shndërruar në legjendë për bukurinë dhe trimërinë e saj. E cilësuar si Helena e Shqipërisë për bukurinë si dhe për faktin që shkaktoi një luftë të madhe mes fisit Kelmendi dhe Perandorisë Osmane, konflikt që zgjati mbi një dekadë.

Nora e Kelmendit, e refuzuar nga babai i saj, për faktin që kishte lindur vajzë, dhe për të nuk ishte e dobishme në luftën kundër pushtuesit, atë e mori dhe e rriti e halla e saj, si një djalë të adoptuar.

I ati i Norës nga dëshira për ta trajnuar e për ta bërë luftëtar dhe duke menduar që ky ishte djali i adoptuar i të motrës, vendosi ta trajnojë si luftëtar, pa e ditur që po trajnonte të bijën e vet.

Kur Nora u rrit, ajo u bë vajza më e bukur e Malësisë. Thuhej se ajo ishte aq e bukur sa një Zanë e vërtetë mali. Fama e bukurisë së saj u përhap nëpër tërë vendin. Një pasha që banonte në Rozafat të Shkodrës, dëgjoji për të.

Një ditë, Nora zbriti në qytet me prindërit e saj. E pashai doli nga kalaja dhe ra në dashuri me Norën sapo ia vuri sytë. Duke qenë nga Bosnja, e cila ka tradita të ngjashme me ato të Shqipërisë, pashai donte të martohej me ligjet shqiptare të Kanunit, që do të thoshte se ai do të dërgonte një njeri të besuar te shtëpia e Norës e të kërkonte dorën e saj.

Megjithatë, familja e Norës u përgjigj se Kanuni shqiptar nuk i lejon martesat e vajzave me jo-shqiptarë. E pashai nuk ishte e mësuar me të tilla refuzime dhe ndërkaq mbante një harem të madh. Ai turfulloi: “Ose Nora do të bëhet gruaja ime, ose unë do ta djeg gjithë Malësinë e do e bëj shkrumb e hi.”

Pashai pastaj udhëhoqi ushtrinë e tij dhe e rrethoi Malësinë. Nora kishte provuar të ishte luftëtare, por tani ajo kishte për detyrë të provonte se ishte edhe e mençur, dhe për këtë duhet të kursente Malësinë nga shkatërrimi. Kështu që ajo hartoi një plan për të vlarë pashain boshnjak.

Ka dy versione të ngjarjes

Në versionin e parë, Nora pretendon se do të martohet me pashain pa lejen e familjes së saj. E veshur me xhubletë, ajo shkon në çadrën e pashait. Pashai, sapo sheh Norën, bie në gjunjë dhe filloi të lutet, duke besuar se Nora ishte një dhuratë e vërtetë nga Allahu i Plotfuqishëm për shërbimet e tij për Atë.

Pashai urdhëron trupat e tij të pushojnë dhe të përgatiten për t’u kthyer në Shkodër. Kur çdo gjë ishte e qetë rreth tendës së pashait, Nora nxjerr kamën që babai i saj i kishte dhënë me vete, kamë që ishte e përcjellë nëpër shumë breza të familjes, dhe ia ngul atë pashait, e shkelmon në pjesën e pasme të kokës, dhe ia zë frymën, kështu që ai nuk mund të bërtiste. Pasi bie pashai për tokë, Nora nuk e godet më pashain, pasi që për shqiptarin është turp ta godasë dikë që nuk është në këmbë, dhe për këtë pashai i shpëton plagëve të marra.

Në një version të dytë të legjendës...

Nora nuk shkon në tendë. Kur ushtritë luftojnë, disa nga Osmanët shpëputen nga trupi i ushtrisë për të sulmuar fshatrat. Nora udhëheq një ushtri prej 300 grash kundër Osmanëve që ishin

duke djegur, plaçkitur e dhunuar, i del përpara pashait dhe e vret në një duel.

Mbi luftën heroike të burrave dhe grave të Kelmendit hedh dritë jo vetëm tradita e pasur popullore por dhe mjaft autorë të huaj dhe vendas, të cilët flasin me admirim për trimërinë dhe vetëmohimin e rrallë të bijve të Kelmendit në këto beteja të pabarabarta. Nora me shoqet e saj të fshehura në shkrepat e thepisura malore, duke përdorur drurët e pishave si leva, rrokullisnin gurë e shkëmbinj mbi kokat e turqve, duke u mbyllur rrugët e kalimit.

Por megjithatë hordhitë e shumta turke të Vuçe pashës edhe pse përgjysmoheshin, ishin aq të shumta sa sikur mbinin nga dheu.

Të shumtë ishin burrat dhe gratë e Kelmendit që dolën vullnetarë për vrasjen e Vuçe pashës, po Nora kërkoi me këmbëngulje që t’i besohej asaj kjo detyrë. Mbas shumë diskutimesh, kuvendi pranoi t’ia plotësojë këtë dëshirë Norës. Dhe rasti erdhi. Kuvendi i kelmendasve, në përgjigje të kërkesës së Vuçe pashës, pranoi propozimin e turqve për të arritur në marrëveshje në qoftë se Vuçe pasha do të pranonte disa kushte. Si

ndërmjetëse për bashkëbisedim kelmendasit dërguan në shtabin e tyre, Norën.

Ata e porositën Norën të tregohej shumë e zgjuar, se kishte të bënte me një pasha dinak, aq shumë i përmendur për kurthe dhe intriga, që nuk di çfarë është besa, fjala e dhënë e shqiptarit. Këta trima i kujtuan Norës vrasjen e pabesë, mbas shpine të përfaqësuesve të Kelmendit para një viti nga Vuçe pasha, i cili jo vetëm nuk i qëndroi fjalës së dhënë për bashkëbisedim me këta malësorë, por me të arritur këta trima në shtabin e tij, urdhëroi menjëherë masakrimin e tyre.

Trimëresha e zgjuar, Nora, e shoqëruar dhe me dy nga trimat më të rinj të kësaj krahine, u nis kaluar drejt shtabit të armikut.

Vuçe pasha i priti në çadrën e tij. Ky komandant dinak i sulltanit, gjatë bisedës me këtë përfaqësuese të Kelmendit mbeti gojëhapur nga bukuria mahnitëse e Norës. Ai i pranoi të gjitha kushtet e kryengritësve, mjaftonte që kjo shqiptarë të bëhej gruaja e tij dhe u ngrit në këmbë e iu afrua Norës. Ajo me shpejtësi si rrufeja nxori kurqelin (një lloj thike që e

mbajnë vajzat për të ruajtur nderin) dhe ia nguli përnjëherësh në zemër pashait të madh osmanli, duke i drejtuar këto fjalë:

“Po të martoj, o pashë më parë me vdekjen” dhe së bashku me shoqëruesit e saj u largua drejt maleve, duke e lënë të shtrirë të mbytur në gjak këtë tiran dinak.

Vdekja e pashait osmanli u përhap si rufe anembanë vendit. Shtabi i armikut i tmerruar nga kjo ngjarje e papritur dhe nga humbjet që pësonte vazhdimisht urdhëroi tërheqjen sa më parë të forcave osmane nga Kelmendi, ndërsa malësorët i ndoqën ato këmba-këmbës.

Sipas gojëdhënave: në këtë betejë malore të pabarabartë, forcat kelmendase kishin gjithsej 900 luftëtarë. Ata me trimërinë, me zgjuarsinë dhe me taktikën e tyre luftarake mundën të shfarosin gjashtë mijë ushtarë turq.

Beteja e Kelmendit kundër osmanlinjve gjatë vitit 1638 përfundoi me fitoren e shqiptarëve. Një pjesë e mirë e kësaj fitoreje erdhi edhe nga lufta e denjë e grave dhe e vajzave të Kelmendit me në krye sokoleshën Nora.



Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg: Të gatshëm të sigurojmë paqen në Kosovë

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg priti në një takim presidenten e Kosovës, znj. Vjosa Osmani. Pas takimit Stoltenberg dhe Osmani kanë dalë në një konferencë për mediat. I pari që mori fjalën ishte shefi i NATO-s, i cili u shpreh se me presidenten e Kosovës, diskutuan për situatën në veri dhe për misionin e ruajtjes së paqes së vazhdueshme në Evropë.

“Sapo diskutuam tensionet në veri të Kosovës, dhe misionin për ruajtjen e paqes së vazhdueshme në Evropë. NATO ka qindra trupa në Kosovë, jemi të gatshëm të përmbushim mandatin tonë, për të siguruar paqen në Kosovë. Jemi në kontakt me organizatat e sigurisë në Kosovë dhe Serbi, sa i përket pikave të ndërmarra nga Kosova për të ulur tensionet.

Për zgjedhjet në veri të Kosovës, për të mos pasur tensione në vazhdimësi, të gjithë personat duhet të veprojnë.

Është një mundësi e Kosovës, e cila është shprehur e gatshme të punojë në lidhje edhe me paqen dhe sigurinë euroatlantike”, - tha Stoltenberg.

Në veri të Kosovës kanë mbetur të plagosur 33 persona, një situatë serioze dhe e papranueshme për stabilitetin e Rajonin. Çdo largim i forcave të policisë nga veriu i Kosovës, kërkon përfshirjen e KFOR-it dhe konsulta të veprimeve nga policia e Kosovës, që mund të ndikojnë në sigurinë e mjedisit.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë konfer-



encës së përbashkët me shefin e NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se sukseset e vendit të saj janë suksese edhe të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Sipas saj, sot Kosova ka demokracinë më të ndritshme në rajon dhe kjo arritje i atribuohet padyshim aleancës.

“Jam këtu si dëshmi e orientimit strategjik të Kosovës. Jemi shumë mirënjohës për lidhshmërinë e NATO-s në këtë kohë mjaft të rëndë. Më lër të shpreh mirënjohjen e popullit të Kosovës për rolin e NATO-s për të shpëtu-

jetët tona dhe rolin gjatë ditëve të sotme. E vlerësojmë rolin e NATO-s në zhvillimin e Kosovës. Sukseset e Kosovës janë suksese të NATO-s dhe për këtë jemi krenarë që kemi demokracinë më të gjallë në rajon.

Duhet të jemi krenar për këto arritje. Saktësisht për shkak se Kosova është sukses historik i NATO-s, ka forca keqdashëse që duan ta sfidojnë dhe ta rrënojnë atë. Nuk duhet ta lejojmë këtë. Kosova dhe rajoni nuk duhet të sfidohen për shkak të keqdashjes ruse. Veriu i Kosovës ka

qenë dhe do të vazhdojë të jetë pjesë e Republikës. Nuk do të lejojmë që veriu të jetë fushëbetje për arritjet hegemoniste të autokratëve rajonalë. Ne jemi për integrimin e veriut. I kam dënuar sulmet e 29 majit ndaj ushtarëve të KFOR-it, që janë organizuar nga krimi serb. Mendimet tona janë me ushtarët e lënduar”, - tha ajo. Më tej Osmani u shpreh se, “Kosova është një histori suksesi e NATO-s. Ne jemi të gatshëm të integrojmë edhe rajonet e tjera, duke iu dhënë hapësira socio-ekonomike”, ndërsa garantoi Sekretarin e Përgjithshëm Stoltenberg se “Do punojmë shumë fort në mënyrë që të mbajmë të forta marrëdhëniet me KFOR-in. Ne kemi nevojë për NATO-n, si një garantues i paqes dhe i mbrojtjes së demokracisë, jemi të gatshëm për të bërë punën tonë”, - shtoi Osmani.

E para e Kosovës, u shpreh se objektivit madhor i vendit të saj është t'i bashkohet sa më parë aleancës. “Objektivi strategjik i Kosovës është t'i bashkohet NATO-s. Kosova nuk do shmanget nga rrugëtimi euroatlantik në asnjë rrethanë. Ky është zotimi që i kemi dhënë gjeneratave të reja. Do të ofrojmë modalitetet më të mira për të avancuar partneritetin tonë dhe qëllimin tonë për anëtarësim në NATO. NATO-ja dhe Kosova janë përherë të lidhura me vete. Na duhet NATO-ja si garantuese e paqes dhe demokracisë”, - theksoi Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Shpenzimet e Mbrojtjes, aleatët përgatiten për të ardhmen

Çështja e nivelit të duhur të shpenzimeve të mbrojtjes për çdo aleat të NATO-s është po aq e vjetër sa është dhe vetë NATO. Ajo prek dy debate thelbësore për aleatët. Së pari, pasi misioni i NATO-s është të sigurojë mbrojtjen e zonës euro-atlantike, shpenzimet e mbrojtjes mbështesin aftësinë e aleatëve për të ruajtur paqen dhe për të frenuar të gjitha kërcënimet, në çdo kohë. Prandaj, shpenzimet e mbrojtjes duhet të përpunohen mirë me mjedisin e sigurisë. Së dyti, shpenzimet e mbrojtjes janë shumë të lidhura me debatin mbi ndarjen e barrës. Aleatët evropianë dhe Kanadaja, shpesh me të drejtë, kritikohen nga Shtetet e Bashkuara se nuk mbajnë pjesën e tyre të drejtë të barrës së mbrojtjes kolektive. Në këtë kontekst, pyetja shtrihet sa i mjafton secilit aleat.

Degradimi i thellë i mjedisit të sigurisë që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014 ka rinovuar debatin për ndarjen e barrës mes aleatëve. Çështja është bërë edhe më e mprehtë që nga pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022, i cili tregoi se rreziku i një konflikti të madh që përfshinte një kundërshtar potencial të armatosur bërthamor nuk ishte aq i largët sa shumë kishin shpresuar.

“Premtimi i Investimeve në Mbrojtje” (DIP) i vitit 2014, i bërë nga aleatët në Samitin e Uellsit 2014, samiti i parë i NATO-s i mbajtur pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë, krijoi një bazë të rëndësishme, duke vendosur objektivin prej të paktën 2% të PBB-së të shpenzuar për mbrojtjen, nga të gjithë aleatët si një angazhim politik i rëndë dakord në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive. Si rezultat i DIP, aleatët Evropianë dhe Kanadaja kanë investuar 350 miliardë dollarë shtesë që nga viti 2014, me tërë vjet radhazi rritje të shpenzimeve të mbrojtjes.

Shpenzimet e mbrojtjes gjatë Luftës së Ftohtë dhe epokës së pas Luftës së Ftohtë

Gjatë Luftës së Ftohtë, shpenzimet e mbrojtjes për aleatët e NATO-s (madje edhe duke lënë mënjënjë Shtetet e Bashkuara) mesatarisht ishin më shumë se 3% të PBB-së, me disa ndryshime të konsiderueshme me kalimin e kohës, por rrallëherë të kenë rënë nën 2%. Në epokën e pas Luftës së Ftohtë, pati një rënie të parë të konsiderueshme në fillim të viteve 1990 dhe një rënie të mëtejshme prej 20% afërsisht 20 vjet më vonë (duke përfshirë një reduktim të strukturës komanduese të NATO-s) pas krizës financiare globale të vitit 2008. Kjo çoi në një rënie të ndjeshme si në vëllimet ashtu edhe në gatishmërinë e Forcave të Armatosura të shumicës së aleatëve. Për më tepër, aleatët e rinj të NATO-s prireshin të ulnin shpenzimet e mbrojtjes ndërsa u bashkuan me Aleancën, duke forcuar perceptimin se disa aleatë ishin të lirë në kurriz të të tjerëve.

Në dekadat e fundit, këto rënie të shpenzimeve të mbrojtjes nga aleatët e NATO-s ishin në kontrast të fortë me tendencat në vende të tjera në botë. Sipas shifrave të bazës së të dhënave të Institutit të Kërkimit të Paqes në Stokholm (SIPRI), që nga viti 2000, shpenzimet ruse të mbrojtjes u rritën me 227% ndërsa ato të Kinës u zgjeruan me 566%. Shpenzimet e mbrojtjes të NATO-s mbetën mjaft të ulëta gjatë të njëjtës periudhë (rritje me vetëm 22% duke përfshirë rritjet e fundit) në Evropë dhe Kanada. Këto shifra mesatare padyshim që nuk kapin diversitetin e situatave nga një aleat në tjetrin, por tashmë tendenca e përgjithshme është kthyer, mjaft ngadalë, vetëm që nga viti 2015.

Zbatimi i Betimit të Investimeve të Mbrojtjes 2014 transformoi peizazhin e mbrojtjes së Aleancës

Pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia, aleatët e NATO-s miratuan Betimin e Investimeve të Mbrojtjes (paragrafi 14 i Komunikatës së Samitit të Uellsit 2014), i cili mbetet edhe sot e kësaj dite themeli politik i angazhimit të tyre për të rritur shpenzimet e mbrojtjes. Ai u formulua me kujdes me synimin për të prodhuar rezultate brenda një dekade (deri në vitin 2024), duke e bërë premtimin kërkues, por realist. Ai jo vetëm që vendosi objektivin prej 2% të PBB-së për shpenzimet e mëdha të mbrojtjes, por gjithashtu përcaktoi një objektiv shtesë për aleatët që të “shpenzojnë më shumë se 20% të buxheteve të tyre të mbrojtjes në pajisje të mëdha, duke përfshirë Kërkimin dhe Zhvillimin përkatës”, që është po aq e rëndësishme, pasi inkurajon aleatët të investojnë në aftësi të reja mbrojtëse. Edhe me këtë nuancë shtesë, u bë shpejt e qartë se numri prej 2% ishte standardi financiar dhe politik kundrejt të cilit do të vlerësoheshin fillimisht përpjekjet e aleatëve, duke përfshirë në kontekstin e grindjeve të rinovuara transatlantike mbi ndarjen e barrës gjatë presidencës Trump.

Siç tregohet në Raportin Vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm të



NATO-s 2022, përpjekja për të arritur këto objektiva ka qenë thelbësore. Që nga viti 2015, sipas shifrave zyrtare të NATO-s, numri i vendeve që përmbushin objektivin 2% shkoi nga 3 në 7 dhe ato mbi objektivin e investimeve 20% u rrit nga 7 në 26, nga 30 aleatë (Finlanda u bë vendi i 31-të anëtar i NATO-s në vitin 2023, dhe për këtë arsye nuk përfshihet në këto shifra). Shumica e aleatëve tani kanë plane të forta për të përmbushur udhëzimet në vitet e ardhshme, dhe së bashku kjo përfaqëson një shtesë prej 350 miliardë dollarësh që janë shpenzuar nga aleatët jo-SHBA (krahasuar me shpenzimet e parashikuara nëse buxhetet kanë mbetur të ulëta që nga viti 2015).

Rindërtimi i forcave dhe rifitimi i aftësive

Edhe pse tërë vjet radhazi rritjet në shpenzimet e mbrojtjes bëjnë një ndryshim, kërkon vite përpjekjesh të vazhdueshme për të rindërtuar forcat që në shumë raste ishin bërë mjaft të zbrazëta. Nga ky këndvështrim, rritjet thelbësore që në ndodhin sot i lejojnë aleatët të ndjekin tre objektiva të lidhura dhe po aq të rëndësishëm.

Së pari, përpjekja më pak e dukshme, por gjithsesi kritike është rindërtimi i forcave në nivelin e duhur të gatishmërisë dhe efektivitetit ushtarak. Shkurtime, kjo ka të bëjë me trajnimin dhe stërvitjen, blerjen e municioneve dhe pjesëve rezervë për të siguruar që forcat e aleatëve të NATO-s të jenë gati për luftim, në një njoftim të shkurtër, në çdo rrethanë dhe në numër të mjaftueshëm. Lufta në Ukrainë ka treguar publikisht se shumë aleatë po përpqeshin të gjenin rezerva municionesh të disponueshme për t'i dhuruar Ukrainës, ose për të riparuar forcat e tyre dhe mund të dislokoni vetëm forca të kufizuara të gatshme luftarake në një njoftim të shkurtër. Kjo linjë përpjekjesh është e një rëndësie kritike për të përmbushur skenarët kërkues që lidhen me mbrojtjen e zonës Euro-Atlantike dhe do të kërkojë një përpjekje të qëndrueshme me kalimin e kohës për të siguruar që aleatët të përmbushin standardet e duhura.

Së dyti, aleatët po trajtojnë mangësitë e aftësive në fusha që ishin lënë pas dore gjatë më shumë se 20 viteve të fokusimit në menaxhimin e krizave dhe angazhimet kundër kryengritjes (p.sh. në Lindjen e Mesme dhe Afrikë më gjerë), të cilat ishin fokusuar në një grup të ndryshëm prioritetesh dhe mjeteve. Procesi i Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s u ka mundësuar aleatët të identifikojnë këto mangësi kyçe të aftësive, dhe kështu të fillojnë rindërtimin e aftësive të nivelit të lartë në domenet tokësore, detare ose ajrore përmes blerjes së platformave dhe mundësive moderne. Aleatët

janë gjithashtu të fokusuar në rindërtimin e kapaciteteve industriale në të gjithë Aleancën. Fushat specifike të fokusit përfshijnë luftën tokësore (blinduar, artileri dhe mundësi), mbrojtjen e integruar ajrore dhe raketeve dhe operacionet nënujore.

Së treti, rritja e shpenzimeve të mbrojtjes i lejon aleatët të përgatiten mirë për të ardhmen. Përparësia teknologjike e NATO-s ka qenë gjithmonë një avantazh kryesor për Aleancën. Investimi në mbrojtje nxit kërkimin, zhvillon gjeneratën e ardhshme të pajisjeve dhe mundësive, dhe siguron që NATO të qëndrojë konkurruese në fusha të reja të operacioneve si hapësira apo hapësira kibernetike. Ky fokus në inovacion është çelësi i suksesit të ardhshëm të NATO-s në një mjedis, ku avantazhi teknologjik i Perëndimit nuk mund të merret më si i mirëqenë. Kjo do të kërkojë një bashkëpunim shumë më të ngushtë me aktorë të ndryshëm në sektorin privat, akademinë dhe autoritetet rregullatore, përfshirë Bashkimin Evropian.

Kushtet e debatit për shpenzimet e mbrojtjes

Ndërsa NATO përmbylli Samitin e Vilniusit në korrik 2023 dhe po i afrohet 75-vjetorit të saj në 2024, kushtet e debatit po evoluojnë me shpejtësi. Gjithnjë e më shumë aleatë shpallin plane për të shkuar mbi objektivin prej 2% dhe për të bërë investime të mëdha në pajisje dhe aftësi të reja. Disa sugjerojnë rishikimin e objektivave lart, ndërsa të tjerë mbeten të shqetësuar me pasojat e një mjedisi të kufizuar fiskal dhe aftësinë e tyre për të përdorur mirë buxhetet që po zgjerohen shumë shpejt. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të pranohet se 2% duhet të jetë një dysheme dhe jo një tavan. Dhe është po aq e rëndësishme që të bëhet fjalë për një përpjekje të qëndrueshme gjatë dekadës së ardhshme dhe më tej, ose të paktën derisa mjedisi i sigurisë të bëhet më qetësues.

Fatkeqësisht, mjedisi i sigurisë në Evropë dhe më gjerë do të mbetet i paqëndrueshëm për të ardhmen e parashikueshme. Sa më gjatë të vazhdojë lufta në Ukrainë, aq më shumë kthehet në një konflikt të zgjatur që kërkon mbështetje afatgjatë për Ukrainën dhe masa të forta parandaluese dhe mbrojtëse për të parandaluar shtrirjen e konfliktit në territorin e NATO-s. Pavarësisht nga rezultati i favorshëm i kësaj lufte, Rusia ka të ngjarë të mbetet armiqësore dhe/ose e paqëndrueshme, me aftësitë e saj kryesore ushtarake kryesisht të pa zvogëluara jashtë territorit tokësor. Në krahun jugor të Evropës, një hark destabiliteti shtrihet nga Afrika Perëndimore në Afganistan, me shtete të shumta gjysmë të dështuara dhe destabilizim të mundshëm të mëtejshëm, të nxitur ndër të tjera nga veprimet ruse. Konkurrenca strategjike me Kinën, duke përfshirë rritjen e pranisë kineze në zonën euro-atlantike, gjeneron rreziqe të mëtejshme të pasojave potencialisht të mëdha.

Për fat të mirë, pavarësisht paqëndrueshmërisë në mjedisin e sigurisë globale, rritja e shpenzimeve të mbrojtjes është kryesisht brenda aftësive fiskale të Aleatëve të NATO-s, të cilët janë disa nga vendet më të zhvilluara ekonomikisht në planet. “Aleatët e NATO-s nuk synojnë të hyjnë në një formë të re të garës së armëve dhe shpenzimet prej 2% mbeten dukshëm nën mesataren e Luftës së Ftohtë. Dhe në mjedisin aktual të sigurisë, opinionin publik mbështet shpenzimet e mbrojtjes, veçanërisht në Evropën Veriore dhe Lindore, dhe kjo mbështetje ka ardhur në rritje.

Ndërsa Aleanca i afrohet 2024-ës, dhjetëvjetorit të Betimit të Investimeve të Mbrojtjes, të gjithë sytë do të përqendrohen te ky afat fillestar për arritjen e objektivit prej 2%. Prandaj Samiti i Uashingtonit i vitit 2024 do të jenë mundësi për udhëheqësit e NATO-s që të rishikojnë arritjet dhe të bien dakord për angazhimet e ardhshme. Këto përfshijnë zotimin e ripërtëritë për të arritur objektivat 2% dhe 20% pa vonesa ose paralajmërime, këto shifra duke u identifikuar si dysheme dhe jo si tavane aspiruese, pasi shumë aleatë tani janë shumë mbi këto standarde; Zotimin për të mbajtur këtë nivel përpjekjeje për aq kohë sa është e nevojshme, gjë që është kritike për rindërtimin e ushtrive tona; Fokusin në adresimin e mangësive të aftësive të identifikuar në Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, duke përfshirë financimin e përbashkët aty ku nevojitet ose më efikas; Reflektimin se si të lidhen më mirë udhëzimet e NATO-s me aktivitetet e BE-së, të cilat po bëhen më domethënëse.

Ditët e Trashëgimisë Evropiane: "Trashëgimia e Gjallë" që feston traditat dhe aftësitë kulturore

Filloan Ditët Evropiane të Trashëgimisë 2023, me dhjetëra mijëra ngjarje që zhvillohen në 48 vende pjesëmarrëse. Tema e këtij viti është "Trashëgimia e Gjallë", e cila do të shfaqë gjallërinë, diversitetin dhe rëndësinë e traditave kulturore, njohurive dhe aftësive në të gjithë Evropën. Nga shtator deri në nëntor 2023, vende dhe monumente të jashtëzakonshme do të hapin dyert për vizitorët. Përveç kësaj, do të zhvillohen ngjarje kulturore, ekspozita, shfaqje artistike, punëtori interaktive, leksione dhe turne me guidë, të gjitha të frymëzuara nga tema e "Trashëgimisë së Gjallë". Këto aktivitete vlerësojnë traditat dhe aftësitë kulturore në formësimin e shoqërive tona.

Organizuar së bashku nga Komisioni dhe Këshilli i Evropës, Ditët Evropiane të Trashëgimisë janë një mundësi për qytetarët që të mësojnë më shumë për kulturën e pasur dhe të larmishme të Evropës dhe të promovojnë mbrojtjen e trashëgimisë sonë të përbashkët për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Këtë vit, iniciativat me ndikim të prezantuara në 2019 do të vazhdojnë. Këto iniciativa përfshijnë Tregimet tërheqëse të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, një platformë e dedikuar për të përforcuar zërat e profesionistëve të trashëgimisë dhe për të vënë në pah përpjekjet e jashtëzakonshme të ruajtjes të kryera nga individë dhe grupe në të gjithë Evropën. Një nismë tjetër e rëndësishme, "Krijuesit e rinj evropianë të trashëgimisë", e njohur më parë si Java e Krijuesve të Trashëgimisë Evropiane, fuqizon dhe ofron një platformë të vërtetë për fëmijët dhe të rinjtë, duke identifikuar kampionët e ardhshëm të trashëgimisë evropiane.

Kjo nismë ka ushqyer gjithashtu projekte të bashkëpunimit ndërkuftar evropian, duke nxitur bashkëpunimin midis vendeve të ndryshme të trashëgimisë. Veçanërisht, u bë një Thirrje e dedikuar për vendet e Etikës së Trashëgimisë Evropiane (EHL), duke rritur sinergjitë midis këtyre nismave. Këto veprime synojnë të forcojnë dimensionin evropian duke miratuar aktivitete ndërkuftare të udhëhequra nga Koordinatorët Kombëtarë të programit të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane. Ndërsa trashëgimia vazhdon, Ditët e Trashëgimisë Evropiane mbeten të përkushtuara për të festuar dhe ruajtur shtatëdhjetë e pasur kulturore të Evropës.

Të iniciuara nga Këshilli i Evropës në 1985, Ditët Evropiane të Trashëgimisë nxisin diversitetin kulturor, dialogun dhe ruajtjen e trashëgimisë. Duke u zhvilluar çdo vit në vendet evropiane pjesëmarrëse, festimet ofrojnë një sërë ngjarjesh dhe aktiviteteve kulturore. Në vitin 2022, rreth 20 milionë njerëz kanë marrë pjesë në Ditët Evropiane të Trashëgimisë.

Që nga viti 1999, të organizuara bashkërisht nga Komisioni dhe Këshilli i Evropës, Ditët Evropiane të Trashëgimisë qëndrojnë si një dëshmi e pasurisë së trashëgimisë kulturore evropiane, duke nxitur dialogun, përfshirjen dhe aktivitetet ndërkuftare. Ditët e Trashëgimisë Evropiane organizohen në bashkëpunim të ngushtë me koordinatoret kombëtarë në secilin prej 48 vendeve që kanë ratifikuar Konventën Evropiane të Kulturës. Çdo vit ka një temë të veçantë, unifikuese pan-evropiane.

"Tani më shumë se kurrë, ne kemi nevojë të mbështesim iniciativat bazë dhe projektet e udhëhequra nga komuniteti. Evropa e njerëzve do të kërkojë veprime të përbashkëta dhe iniciativa nga poshtë-lart. Kjo shkon në thelbin e mënyrës sonë të jetesës dhe vlerave që e mbështesin atë", - shprehet Margaritis Schinas,

EUROPEAN
HERITAGE DAYS
2023

Living
Heritage



Zëvendës-President për Promovimin e "Mënyrës sonë Evropiane të Jetës". Sigurisht një nga vendet pjesëmarrëse nuk mund të mos ishte edhe Shqipëria. Me temën "Trashëgimia e qëndrueshme",



Ditët Evropiane të Trashëgimisë do të organizohen përgjatë kësaj periudhe, me një larmi aktiviteteve të shtrira në qytete të ndryshme të Shqipërisë.

KE: Ta bëjmë më të lehtë për evropianët të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë jashtë vendit

Komisioni European ka propozuar hapa konkretë për dixhitalizimin e mëtejshëm të koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore në Evropë. Ai parashtron veprime për ta bërë aksesin në shërbimet e sigurimeve shoqërore më të shpejtë dhe më të thjeshtë përtej kufijve, duke përdorur plotësisht mjetet dixhitale, duke reduktuar barrën administrative për qytetarët dhe biznesin. Kjo do të përmirësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve kombëtare të sigurimeve shoqërore dhe do të përshejtojë njohjen dhe dhënien e përfitimeve të pranueshme përtej kufijve. Kështu do ta bëjë më të lehtë për evropianët të jetojnë, të punojnë dhe të udhëtojnë jashtë vendit, për kompanitë të bëjnë biznes në vende të tjera të BE-së dhe për administratat kombëtare të koordinojnë sigurimet shoqërore përtej kufijve.

Pavarësisht nismave të mëparshme për të përmirësuar rrjedhën ndërkuftare të informacionit të sigurimeve shoqërore, institucionet kombëtare, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe inspektoriatet e punës ende përballen me vështirësi në aksesin dhe shkëmbimin e të dhënave, për shkak të ndërveprimit të pamjaftueshëm midis sistemeve kombëtare. Ky komunikim bën një pasqyrë të progresit të arritur deri më tani në dixhitalizimin e koordinimit të sigurimeve shoqërore, paraqet iniciativat e vazhdueshme në këtë fushë dhe propozon veprime të ardhshme për të shfrytëzuar plotësisht përfitimet që mund të ofrojnë dixhitalizimi. Masat kryesore të propozuara nga Komisioni për shtetet anëtare janë:

Përshejtimi i zbatimit kombëtar të Shkëmbimit Elektronik të Informacionit të Sigurimeve Shoqërore (EESSI) në mënyrë që ai të jetë plotësisht funksional deri në fund të vitit 2024 në të gjithë Evropën. EESSI dixhitalizon shkëmbimet ndërmjet institucioneve kombëtare të sigurimeve shoqërore, për t'u larguar nga procedurat e bazuara në letër, që kërkojnë kohë dhe të rënda; Ofrimi i më shumë procedurave të koordinimit të sigurimeve shoqërore plotësisht në internet, për ta bërë edhe më të lehtë për njerëzit të lëvizin dhe të punojnë jashtë vendit dhe të sigurohen që ata të kenë akses të shpejtë në përfitimet e tyre të pranueshme. Shtetet Anëtare mund të bazohen në Rregulloren "Single Digital Gateway", e cila parashikon një dorëzim plotësisht online të disa procedurave të rëndësishme administrative për qytetarët dhe bizneset më së voni deri më 12 dhjetor 2023; Angazhimi plotësisht në aktivitetet pilot të "European Social Security Pass" (ESSPASS), të cilat eksplorojnë se si të thjeshtohet lëshimi dhe verifikimi i të drejtave të qytetarëve për sigurimet shoqërore përtej kufijve; Puna drejt futjes së identitetit dixhital të BE-së (EUDI), i cila do t'u lejojë qytetarëve të BE-së të mbajnë versione dixhitale të dokumenteve të të drejtës, të tilla si Karta Evropiane e Sigurimit Shëndetësor (EHIC), duke e bërë më të lehtë për institucionet e sigurimeve shoqërore, inspektoriatet e punës dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor të verifikojnë këto

dokumente. Komisioni do të mbështesë Shtetet Anëtare të BE-së në zbatimin e këtyre veprimeve duke ofruar asistencë teknike, duke përfshirë përmes Instrumentit të Mbështetjes Teknike dhe duke vënë në dispozicion fondet e BE-së, për shembull përmes Programit të Evropës Dixhitale, InvestEU, Fondit Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe Fondit Social Evropian. Plus.

Autoriteti Evropian i Punës do të luajë gjithashtu një rol aktiv duke mbledhur shembuj të praktikave më të mira dhe duke lehtësuar shkëmbimet e rregullta ndërmjet autoriteteve kombëtare.

Përpunimi i dixhitalizimit të koordinimit të sigurimeve shoqërore është gjithashtu i rëndësishëm në kontekstin e negociatave të vazhdueshme nga bashkë-ligjvënësit për rishikimin e rregullave të koordinimit të sigurimeve shoqërore të BE-së. Shtetasit e BE-së kanë të drejtë të udhëtojnë, punojnë dhe jetojnë në një vend tjetër të BE-së. Në vitin 2021, 16 milionë njerëz nga BE, Zona Ekonomike Evropiane (ZEE)/Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (EFTA) dhe Zvicra jetuan dhe/ose punuan në një vend tjetër të BE-së, ZEE/EFTA dhe Zvicër. Rregullat e BE-së (Rregullorja Nr. 883/2004 dhe Rregullorja Nr. 987/2009 mbi zbatimin e saj) mbrojnë të drejtat e sigurimeve shoqërore të njerëzve kur lëvizin brenda Evropës.

Manastiri i Ardenicës, historia e një udhëtimiti në kohë

Manastiri i Ardenicës, i njohur për historinë dhe trashëgiminë e tij të pasur fetare dhe kulturore, ka qenë një qendër e rëndësishme për besimtarët, studiuesit dhe të interesuarit për të njohur thellësisht pasurinë e Myzeqesë.

Manastiri i Ardenicës “Lindja e Hyjlindjes” mban emrin e Marisë Hyjlindisë, ashtu si shumica e kishave të trevës së Myzeqesë, në të cilën ajo njihet si mbrojtëse e veprimtarisë kryesore ekonomike të kësaj krahine: bujqësisë.

Manastiri i Ardenicës vërtet i përket periudhës bizantine, por formën e tij të sotme ai e ka marrë gjatë shekullit XVIII.

Fshehur midis kodrave dhe natyrës së pjerrët të rajonit, ai ka qenë një oazë e qetësisë dhe besimit për të krishterët ortodoks të rajonit.

Nga momenti i themelimit të tij, manastiri ka pasur një rol kyç në zhvillimin e identitetit fetar dhe kulturor të popullatës shqiptare.

Mësues të njohur të kohës dhe shkrimtarë të njohur kanë lënë gjurmë të thella në historinë e Manastirit të Ardenicës.

Këtu, përkundër sfidave të kohës, u zhvilluan aktivitete shkollore dhe kulturore të rëndësishme.

Mendohet se themelet e këtij manastiri janë hedhur në vitin 1282 me nismën e perandorit Andronik II Paleolog të Bizantit, i cili e ngriti këtë tempull pas fitores mbi anzhuinët në Berat. Shtysë për këtë veprim do të jetë bërë ndodhja në atë vend e kapelës së Shën Triadhës, e ngritur aty shekuj më parë. Ekziston hipoteza se kapela mund të jetë ndërtuar në themelet gërmadhë të një tempulli pagan, i cili ka qenë ndërtuar për nder të hyjneshës Artemisa, nga ka rrjedhur dhe emri i sotëm Ardenica. Fare pranë këtij tempulli, në rrethinat e të cilit sot ndodhet manastiri, kalonte dega jugore e rrugës antike Egnatia, pikërisht 1 km në perëndim të tij. Për rreth manastirit shikohen, aty-këtu, ndërtime të vjetra, të cilat të japin mendimin se rreth tij ka pasur ndoshta një qendër të banuar. Sipas defterit osman të vitit 1431-'32, në nahijen e Myzeqesë, ndodhej fshati Ardenicë me tetë shtëpi, i cili mund të jetë shtrirë përreth manastirit. Dëshmi tjetër, për rëndësinë e këtij manastiri është dhe fakti që po zë një vend gjithnjë



e më të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë, se në altarin e Kishës së manastirit të Ardenicës, është bërë edhe kurorëzimi i martesës së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti me Andronika Arianitin. Ceremoniali u bë në mesditën e 21 prillit 1451 nga peshkopi i Kaninës Feliks, në prani të princave shqiptarë dhe ambasadorëve të Napolit, Venedikut etj.

Arkitektura

Manastiri është i tipit bizantino-ortodoks. Ai, së bashku me konakët që i janë shtuar më vonë, zë një sipërfaqe prej 2.500 m². Ky monument përbëhet nga kisha e Shën Mërisë, kapela e Shën Triadhës, konakët, mulliri i vajit, furra, stalla, etj. Në qendër të tij ndodhet kisha “Lindja e Shën Mërisë”, e cila është ndërtuar pjesërisht me gurë të

sjellë nga Apolonia dhe gurë shtufi. Kisha është e tipit Bazilikal. Ajo zë një vëllim të madh dhe është e mbuluar nga një çati druri me tavan të rrafshët. Mjediset që përbëjnë këtë kishë janë: naosi, narteks, egzonarteks dykatësh, ku në fund u bashkëngjitet kambanorja e lartë 24 m. Në anën jugore ndodhet portiku i hapur i ndërtuar me kolona dhe harqe. Naosi përbëhet nga tre pjesë, të cilat ndahen në dy rreshta kolonash prej druri. Naosi ndahet nga altari me anë të ikonostasit. Dyshemeja e kishës është shtruar me pllaka guri, e cila përfshin edhe ambientet e narteksit dhe egzonarteksit.

Në vitin 1743 me nismën e peshkopit të Beratit, Metodit, i cili ishte me origjinë nga Bubullima (Myzeqe), u bënë në këtë manastir

punime rregulluese përfshirë edhe kishën e Shën Mërisë. Kapela e Shën Triadhës shtrihet në pjesën verilindore të manastirit dhe ka përmasa 7,50 m x 3,70 m.

Hyrja e saj është në anën perëndimore dhe është e pajisur me dy dritare të vogla në faqen jugore. Kjo kapelë është ndërtuar me gurë shtufi dhe është e pajisur me një hapësirë, muri gjysmërrethi i së cilës e ndan atë nga një sternë uji. Porta e kapelës është mbuluar me hark guri, pranë dritares lindore të saj ndodhet edhe një relief qeramike.

Manastiri u bë një qendër e studimeve të krishtera, por jo vetëm.

Këtu u trashëguan dhe u ruajtën tekste të rëndësishme fetare dhe kulturore, duke kontribuar në ruajtjen e pasurisë shpirtërore të popullit shqiptar nëpërmjet periudhave të vështira.

Trashëgimia artistike e Manastirit të Ardenicës është një tjetër thesar i çmuar. Ikonat dhe afresket e tij shprehin thelbin e identitetit të kombit shqiptar, ndërsa arkitektura e tij ndryshon nga tiparet e zakonshme të kishave ortodokse të rajonit.

Kjo ndërthurje e elementëve artistikë dhe arkitektonike ka krijuar një ndërtesë të shenjtë dhe të mrekullueshme, e cila përbën një pikë referimi, jo vetëm fetare, por edhe kulturore.

Një vizitë në Manastirin e Ardenicës është një përvojë e ngjashme me një udhëtim në kohë. Hap pas hapi, ndiheni të lidhur me historinë dhe traditën e një populli që ka ruajtur besimin e tij përkundër vështirësive të pafundme.

Ky vend i shenjtë dhe i bekuar ofron qetësi për meditim, njohuri për historinë, dhe admirim për trashëgiminë shpirtërore të Myzeqesë dhe tërë kombit shqiptar.

Në këtë mënyrë, Manastiri i Ardenicës vazhdon të qëndrojë si një simbol i fortë i identitetit fetar, historik dhe kulturor të Myzeqesë dhe gjithë Shqipërisë.

Përmes pasurisë së tij trashëgimore, ai thërret të gjithë ata që janë të interesuar të zbulojnë rrënjët dhe thellësinë e kësaj toke, ku historia dhe besimi lidhen për të formuar një peizazh të pashembullt shpirtëror.



Fakte magjepsëse rreth gjeografisë që ndoshta nuk i dini

Nga thellësitë më të thella të oqeanit deri në majat më të larta të maleve, bota në të cilën jetojmë është plot me mrekulli dhe mistere të bukura. Dhe ndërsa ne jemi përpjekur t'i japim kuptim këtij planeti për shekuj, ka ende shumë gjëra që shumë prej nesh nuk i dinë, për planetin e jashtëzakonshëm në të cilin jetojmë, pavarësisht nëse sapo keni mbaruar shkollën ose jeni diplomuar dekada më parë.

Për shembull: A ishit në dijeni se Oqeani Paqësor po tkurret çdo vit? Apo se Alaska nuk është vetëm shteti më perëndimor në SHBA, por edhe më lindor?



Antarktida është shkretëtira më e madhe në botë

Kur imagjinoni një shkretëtirë, ndoshta nuk e imagjinoni Antarktidën. Sidoqoftë, përkufizimi i shkretëtirës është në fakt vetëm një zonë toke që nuk ka më shumë se 254mm reshje në vit. Me këtë përkufizim në mendje, shkretëtira më e madhe në botë është Antarktida!



Rusia është aq e madhe sa është shtëpia e 11 zonave kohore

Duke mbuluar 6.6 milion milje katrore (17 milion km²), Rusia është vendi më i madh në botë, kështu që ka kuptim që hapësira e saj tokësore e saj të përhapet në zona të shumta kohore.



Ishujt Diomede kanë një diferencë kohore prej 21 orësh mes tyre

Ishujt Diomede përbëhen nga Diomedi i Madh, në pronësi të Rusisë dhe Diomedi i Vogël, në pronësi të SHBA-së. Dhe për shkak të diferencës së tyre kohore, ata janë mbiquajtur "Tomorrow and Yesterday Island".



Stambolli është i vetmi qytet në botë që shtrihet në dy kontinente

Dëshironi të vizitoni dy kontinente në një udhëtim? Shkoni

në Stamboll! Ngushtica e Bosforit ndan anët evropiane dhe aziatike të qytetit.



Kontinentet mund të lëvizin me të njëjtin ritëm si rriten thonjtë

Është tipike për një kontinent që të zhvendoset rreth një inç (2,54 cm) në vit, por kur pllakat tektonike janë nën stres, ato mund të lëvizin rreth 20 herë më shpejt, që është e njëjta shpejtësi me rritjen e thonjve tanë.



Malet Apalachian po zvogëlohen

Disa besojnë se Apalachians ishin dikur aq të lartë sa Himalajet. Por për shkak të shiut të vazhdueshëm dhe erozionit të erës, këto vargmale janë zvogëluar.



Në të kundërt, malet Himalaje janë në rritje

Himalajet janë ende në rritje sot, me rreth 1,98cm në vit, sepse pllakat tektonike nën Indi dhe Azi vazhdojnë të shtyhen në njëra-tjetrën. Megjithatë, si Apalachians, Himalajet gjithashtu po gërryen, por me një ritëm më të ngadaltë se ai me të cilin po rriten.



Deti i Vdekur po fundoset, por ti nuk do të fundosesh në detin e vdekur

Tashmë në 429 m nën nivelin e detit, Deti i Vdekur po fundoset rreth 1 m në vit. Deti i Vdekur ka 8 deri në 9 herë më shumë kripë se oqeanet dhe detet e botës, gjë që krijon një dendësi që ju bën të qëndroni në sipërfaqe. Hyni në Detin e Vdekur dhe shtrihuni, këmbët tuaja do të dalin drejt në sipërfaqe!



Australia është në fakt më e gjerë se Hëna

Hëna ndodhet në 3,400 km në diametër, ndërsa Australia është pothuajse 4,000 km nga lindja në perëndim. Sigurisht, për sa i përket sipërfaqes, Hëna mund Australinë.



Në Filipine, ka një ishull që është brenda një liqeni, në një ishull që është brenda një liqeni, në një ishull

Vulcan Point është një ishull brenda liqenit të kraterit kryesor, i cili ndodhet në ishullin vullkanik, i cili ndodhet në liqenin Taal, i cili ndodhet në ishullin Luzon. Marramendëse!



Një përqindje e madhe e oksigjenit të Tokës vjen nga Amazona

Është vlerësuar se 20% e oksigjenit të Tokës prodhohet nga pyjet tropikale të Amazonës, prandaj ne duhet ta mbrojmë atë!



Përqendrimi më i madh i liqeneve është në Kanada

Me 879,800 liqene, Kanadaja ka më shumë liqene se kudo tjetër në botë. Në thelb, ata kanë 62% të liqeneve të botës!



Toka ka mjaftueshëm ar sa për t'u mbuluar në të

Nxjerrja e arit duket sikur është drejt fundit, por ndoshta kjo nuk është vërtetë kështu. Ka mjaft ar në bërthamën e planetit, sa për të mbuluar të gjithë Tokën me një shtresë prej 45cm të mineralit.



Në shkretëtirën e Saharasë bie borë

Temperatura e Saharasë është mesatarisht 30°C, por në mbrëmje fillon ftohja, mesatarisht 12°C. Në vitet më të fundit, Sahara regjistroi reshje dëbore në 1979, 2016, 2018 dhe 2022.



Memoriali më i madh i luftës në botë është një rrugë

Kur ushtarët australianë u kthyen në shtëpi nga Lufta e Parë Botërore, atyre iu ofruan punë për të ndërtuar një rrugë përgjatë bregdetit. Deri në kohën e përfundimit në 1932, Rruga e Oqeanit të Madh shtrihej 243 km.

Janë mbi 7000 ishuj të Karaibeve



Vendi i 13 kombeve ishullore sovraane, rajoni i Karaibeve në fakt përfshin më shumë se 7000 ishuj.

Arkipelagu i Filipineve përbëhet nga 7,641 ishuj - disa qindra më shumë se 7,107 ishujt që shkencëtarët besonin më parë se vendi përmbante.

Emri i plotë i Bangkokut përbëhet prej 163 shkronjash



Qyteti me emrin më të gjatë është Krung Thep Mahanakhon Amon Rattanakosin Mahinthara Yuthaya Mahadilok Phop Nopparat Ratchathani Burirom Udomratchaniwet Mahasathan Amon Piman Awatan Sathit Sakkathattiya Witsanukam Prasit. Në vend që të përdoret me këtë emër me 21 fjalë, qyteti mban pseudonimin e tij të njohur gjerësisht: Bangkok. Ky emër i vërtetë është emri më i gjatë i çdo vendi në tokë.



Uji mbulon pjesën më të madhe të planetit, por shumica e tij nuk mund të përdoret nga njerëzit

71 për qind e Tokës përbëhet nga uji, por vetëm 0,007 për qind e tij mund të përdoret nga njerëzit.

Përse kështu? Për një gjë, vetëm 2.5 për qind janë ujëra të ëmbla; pjesa tjetër është e kripur dhe e bazuar në oqean. Për më tepër, nga ky ujë i ëmbël, vetëm 1 për qind është lehtësisht i aksesueshëm, me pjesën tjetër të bllokuar në akullnaja dhe fusha dëbore.

Lindja e Mesme importon rërë nga Australia




Mund të ketë shumë rërë në Lindjen e Mesme, por jo lloji i rërës që nevojitet për ndërtim. Kjo është arsyeja pse vende si Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe importojnë rërë nga Australia.



Alaska është shteti më perëndimor dhe më lindor në SHBA

Ju mund të mendoni për Alaskën si shtetin më perëndimor në Shtetet e Bashkuara, veçanërisht kur shikoni një hartë, por është gjithashtu shteti më lindor. Si? Për faktin se shtrihet aq larg nga perëndimi sa bie në hemisferën lindore. Në fakt, Semisopochnoi, një ishull i vogël i pabanuar, pjesë e Ishujve Aleutian të Alaskës, është teknikisht pika më lindore në të gjithë Amerikën e Veriut.



Vendi më i thellë në Tokë është në Oqeanin Paqësor

Brenda Hendekut Mariana, vendi më i thellë në Tokë, ekziston një gropë e vogël e quajtur Thella Challenger, e cila arrin thellësinë 10,971 m.



Damasku është qyteti më i vjetër në botë, i banuar vazhdimisht

Qyteti më i vjetër ka qenë i banuar vazhdimisht për të paktën 11,000 vjet dhe aktualisht është shtëpia e mbi dy milionë njerëzve.



Në Sudan ka më shumë piramida të lashta sesa në Egjipt

Egjipti është shtëpia e 138 piramidave, ndërsa Sudani ka midis 200 dhe 255 piramida të njohura, të ndërtuara për mbretëritë Kushite të Nubisë.

KOLONEL GJON VORFI - USHTARAKU MADHOR QË SHËRBEU DENJËSISHT NË FORCAT E ARMATOSURA DHE POLICINË E SHTETIT



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në rrënjët e oxhakut “Vorfi”. Është e njohur shprehja “Bëmë baba të të ngjaj”. Shembullin e babait për atdhetari dhe përkushtim ndaj Atdheut, e ndoqi edhe i biri, Gjon Vorfi që në fëmijëri dhe përgjatë gjithë rrugëtimit jetësor. Gjon Preng Vorfi është lindur, më datën 27 gusht 1958, në Sukagji të Lezhës, në një ambient fisnik atdhetar, oxhakun e të cilëve nuk e kishin përkulur pushtimet dhe rrebeshet e kohës. Babai i Gjonit, Preng Pjetër Vorfi kishte lindur më 1920 në Sukagji, fshat i Lezhës me rreth 150 shtëpi. U përball me sfidat e jetës duke i dalë krah familjes, ndërkohë që u burrërua para kohe. Sikurse shumë nga bashkëmoshatarët e tij, iu bashkua formacioneve luftarake partizane. Ai ishte pjesëmarrës në Luftën Antifashiste në BrVIIS, brigadë që në ditën e parë kishte 400 luftëtarë dhe që në fund numri shkoi në 1200 partizanë. Kjo brigadë përshkroi 3200 km rrugëtim luftarak të suksesshëm, që bashkë me 20 000 luftëtarë të tjerë ishin kontribuues për çlirimin e Shqipërisë por edhe të trojeve shqiptare në Kosovë, Bosnje-Hercegovinë dhe Mal të Zi, si ish-luftëtar i Brigadës së shtatë sulmuese. Nga radhët e BrVIIS ranë në fushën e betejave 232 dëshmorë. Në vitet 1945-1948 ka punuar në Vaun e Dejës dhe më tej edhe në Lezhë në qytet deri më 1958, kohë që u rikthye në fshatin e tij në Sukagji. Pas LANÇ-it krijoi familjen e tij dhe së bashku me bashkëshorten Gjela Nikollë Dedgjoni/Vorfi lindën, rritën dhe edukuan 9 fëmijë, katër djem dhe pesë vajza. Preng Vorfi ngeli përgjatë gjithë jetës një njeri i nderuar dhe respektuar në krahinë dhe në qytetin e tij të Lezhës deri kur ndërroi jetë më 1979 në moshën 59 vjeçare.

Karrierë e suksesshme ushtarake

Të dhënat për Gjon Preng Vorfin gjenden lehtësisht në Qendrën e Personel Rekrutimit (QPR), sikurse gjithë ushtarakëve të tjerë. Por nëse e shikon me vëmendje ecurinë në karrierë të tij nuk e ke të vështirë të dallosh kulturën dhe edukatën e gjerë qytetare të admirueshme, që e rrezatoi që kur ka qenë drejtues i k2b2 këmbësor në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe më tej në të gjitha detyrat. Gjon Vorfi ka dosjen me nr. “26405”, por duke e pasur epror dhe koleg për këto vitet e fundit e kemi më të lehtë të depërtojmë tek të dhënat e karrierës, edhe kur të dhënat shfaqen Gjoni i ofron me shumë kursim, deri edhe nuk e ka për zemër që të dhënat e tij të jenë objekt në gazetë. Megjithatë të njohësh vlerat dhe kontributet edhe të njerëzve që kanë



shumë vlera por futen në grupin e “rezervimit të të dhënave”, që të duhet pak kohë për t’iu mbushur mendjen se brezat duhen ushqyer me vlerat që në fakt kanë pasur njerëzit në Forcat e Armatosura dhe jo vetëm. Pse jo, është edhe detyrim për misionet e kryera me sukses dhe këtë përvojë e eksperiencë të pasur nuk mund ta burgosim dhe ta quajmë si dikur “TSRV”, ndërkohë që transmetimi i eksperiencave është detyrim brezash për zhvillimin e mëtejshëm të vendit në gjithë sektorët e saj.

Gjon Preng Vorfi, i datëlindjes 27.08.1958, arsimimin fillor dhe tetëvjeçar e ka kryer në vendlindje, në 1965-1973, në shkollën 8-vjeçare Kashnjë, me rezultate shumë të mira, ndërsa arsimimin e mesëm e ka kryer në vitet 1973 deri në vitin 1977, në Shkollën e Mesme të Kulturës në Tiranë me rezultate të shkëlqyera. Të mësuarit gjatë gjithë jetës ka bërë që Gjon Vorfi, nga viti 2001 deri më 2013, të kryejë kurset e orientimit për burimet njerëzore, të

programimit dhe menaxhimit të burimeve të mbrojtjes, për auditor i burimeve të mbrojtjes së NATO-s, për marrëdhëniet civilo-ushtarake CIMIC, terminologjisë ushtarake të NATO-s, kurs orientues dhe trajnime të NATO dhe pfp, si dhe kursi i menaxhimit dhe sigurisë së Informacionit. Në pikëpamje të karrierës, pas kryerjes së stazhit në Kalivaç të Lezhës, pa dëshirën e tij dërgohet në SHLBO. Ai ka përfunduar studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, në vitet 1978-1982. Megjithëse arsimimi mbeti objektiv themelor i pandryshueshëm i Gjon Vorfit përgjatë gjithë jetës. Pas titullimit oficer, Gjon Vorfi, ka shërbyer në detyra të shumta në strukturat ushtarake në Tiranë, Shkodër, në NATO, në Bruksel dhe me studime në Shkollën e Luftës në Paris, pra ka shërbyer si oficer aktiv nga viti 1982 deri në daljen në rezervë më 2014, plot 36 vite nën uniformë në shërbim të shtetit në dy regjime. Në vitin 1985, Gjon Vorfi me kërkesën e tij largohet në Shkollën e Kuadrore rezervistë

Vau i Dejës në Shkodër, me detyrën Pedagog taktike, dhe më tej Komandant Batalioni, Shef Edukimi në Brigadë dhe Shefi i Marrëdhënieve me Publikun në Divizion këmbësor të Shkodrës. Një nga detyrat sinjifikative ka qenë ajo që ka kryer në vitin 1997-1998, kur ka shkuar në mision në Bosnje-Hercegovinë si “gazetar”, reporter në Qendrën e Shtypit dhe Informacionit i gazetës “SFOR Informer” të NATO-s (Qendra e shtypit dhe Informacionit të NATO-s në Sarajevë), që bën pjesë ndër misionet e para që kryenin ushtarakët shqiptarë jashtë vendit. Në vitin 2000 emërohet në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë (Sektori i Atasheve) në MM. Në vitet 2002 - 2003 kryen me sukses Shkollën e Luftës, (Ecole Interarmee de Defence) në Paris. Në vitet 2004 - 2009 ka qenë në përfaqësinë Ushtarake shqiptare në Bruksel, që ka qenë në fakt periudha më intensive e marrëdhënieve me NATO-n, për një personel më katër vetë, mbulohen të gjitha veprimtaritë në shtabin qendror të NATO-s (HQ NATO).

Puna si Oficer i Shtabit në PU të RSH pranë NATO-s, përfaqësues permanent për mbi pesë vite në funksion politiko-ushtarak e diplomatik, ku fitoi eksperiencë të jashtëzakonshme në fusha dhe çështje si: siguria, operacionet, armatimet, logjistikë, emergjencat civile, mbrojtja e infrastrukturës, mbrojtjen kibernetike dhe sigurisë së informacionit, menaxhimin e buxhetit dhe të menaxhimit të ciklit jetësor të burimeve, në fushën e kërkimit shkencor dhe teknologjisë. Në NATO Gjon Vorfi ka qenë pjesëmarrës në takime pune por edhe ka përgatitur raporte, brifingje, analiza e vlerësime si dhe propozime para ftesës për anëtarësim të Shqipërisë në Bukuresht më 2008-ën, ashtu edhe pas marrjes së ftesës për anëtarësim të plotë në Aleancën e Atlantikut të Veriut në Samitin e Köln-Strasburgut, në prill 2009. Për dy vite, më 2009 – 2010, ka kryer detyrën e shefit të kabinetit i SHSHFA, ndërsa në vitin 2011 ka kryer detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Politikave të Burimeve njerëzore në MM. Në vitet 2012 – 2014, ka qenë Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Burimeve Njerëzore të NATO-s, në IMS (International Military Staff) në NATO HQ Bruksel, vend i fituar me Biding Process – Konkurrim kandidaturash nga 28 vendet e NATO-s. Një ndër detyrat prestigjioze dhe që meriton vlerësime është ajo e Kryetarit të Auditit për Burimet Njerëzore të NATO-s, pozicion gjatë të cilit ka udhëhequr një shtab të përbërë nga ekspertë përfaqësues të vendeve anëtare të NATO-s si autoriteti drejtues përgjegjës direkt për validimin e strukturave organizative ushtarake të NATO-s, duke këshilluar dhe u bërë rekomandime vendeve anëtare të NATO-s lidhur me përdorimin e burimeve njerëzore, të personelit ushtarak dhe për çështjet organizative. Nën drejtimin e Gjon Vorfit Autoriteti i Auditit si institucion i pavarur i NATO-s, fitoi besimin dhe nderimin e vendeve anëtare të NATO-s, kjo e demonstruar dhe me vlerësimet e dhëna me shkrim nga autoritetet më të larta të NATO-s. Pas përfundimit të karrierës ka punuar edhe si këshilltar për sigurinë në fillim pranë “Klik Ekspo Group” dhe pastaj me kompaninë e sigurisë private ARB, për llogari të TAP, deri në mars 2019, kur ka filluar punë deri

në pensionim me detyrë në Akademinë e Sigurisë në sektorin e Botimeve në Qendrën Kërkimore Shkencore dhe Projekteve.

Ekselent në të gjitha shkollat, akademitë, kualifikimet, trajnimet e specializimet

Shkolla dhe librat kanë qenë pasioni i përhershëm i Gjon Vorfit, edhe pse në kohën e lirë edhe fizarmonika, që i jepte muzikalitet shpirtit. Pasionant pas leximit, përfshi edhe gjuhët e huaja anglisht, frëngjisht e italisht, Gjon Vorfi e dinte mirë thënien profetike aristoteliane se, “rrënjët e shkollimit janë të hidhura, por frytet janë të ëmbla”. Ai ishte përjetësisht i lidhur me librat, ndërkohë që Latinët thoshin “Habent sua fata libelli/Librat kanë fatin e tyre”, ndërsa filologu ynë i madh Sami Frashëri thoshte se “nëse do të mbjellësh përgjithmonë, mbill arsim dhe kulturë”. Prandaj destinacioni shkollor i Gjon Vorfit ishte shkolla, arsimit dhe kultura, për të qenë i denjë me fuqinë që të jep drita e diturisë dhe intelektualizmit, pasi “jeta pa dije është si të shkosh në luftë pa armë!”. Etiketimimi për Gjon Vorfin, diplomuar “Shkëlqyeshëm”, ishte një normalitet. Gjon Vorfi nga gjithë brezat e shokëve të tij si dhe nga dokumentacioni i depozituar në arkivin e kartotekën e QPR-së rezulton me etiketimin: “Student dhe kursant i shkëlqyer” i të gjithë shkollave dhe akademive ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, përfshi edhe shkollimin në Francë. Ai u dallua për zell e ambicie të lartë për dije të thelluara dhe të qëndrueshme, çka e rrezatoi atë përgjatë gjithë detyrave të tij në karrierën e gjatë ushtarake dhe në vitet e fundit edhe atë policore. Që në ditët e para të karrierës e përgjatë gjithë kohës nuk e ndali studimin, punën e shkrimit, duke e parë librin dhe bibliotekën si të shenjtë, të domosdoshme, bashkudhëtarë të suksesit dhe ngritjes e konsolidimit të personalitetit. Prandaj ai e formatoi bindshëm dhe denjësisht individualitetin e mençurisë, duke ia kryer miqve, bashkëpunëtorëve, shokëve, kolegëve, dijet dhe seriozitetin në çfarëdo lloj pune. Nga ana tjetër ka mbajtur lidhje e bashkëpunim të ngushtë me shokë e kolegë të shumtë. Kushdo që e njeh nga afër Gjon Vorfin e vlerëson si një aset të mençur që ka qenë në dispozicion të strukturave ushtarake me njohuritë e tij solide, duke lënë emrin e një ushtaraku madhor të klasit të lartë, por dhe figurën e disiplinuar e njerëzore me kulturë të lartë, kulturë që ua ka transmetuar të dy fëmijëve të tij, që punojnë aktualisht, djali në Ministrinë e Mbrojtjes së Belgjikës dhe vajza në një kompani biznesi prestigjioze në Dubai.

Kontribuues në fushën e publicistikës së mbrojtjes dhe sigurisë

Pas përmbushjes me sukses të karrierës ushtarake, ka qenë ish-Rektori i AS-së, gjeneral prof. asoc. dr. Bilbil Mema, që ia njihte vlerat, duke e punësuar Gjon Vorfin si personel akademik në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve në Akademinë e Sigurisë, strukturë vartëse e Policisë së Shtetit. Në vitet kur Gjon Vorfi ishte në kulmet e njohurive të akumuluar përgjatë më shumë se tre dekadave e gjysmë ishte fat për Akademinë e Sigurisë për të patur një vlerë më shumë, si lektor i lëndës “Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri”, por edhe si punonjës akademik që njohuritë i ka vendosur në interes të progresit të Akademisë së Sigurisë dhe Qendrës së Kërkimit Shkencor. Përgjithësisht ka qenë i kursyer në fjalë dhe i matur, ndoshta më shumë se duhet. Por gjithsesi “..e shkruar ngelet”, sikurse thonë latinët dhe firmën Gjon Vorfit e gjejmë në gazeta, revista, veçanërisht në gazetën “Ushtria”, revistën “Mbrojtja”, “Albanian Armed Forces”, “Policimi dhe Siguria”. Me një vështrim të shpejtë gjejmë shkrime që lidhen me sigurinë kombëtare dhe globale, me pranimin e Shqipërisë në NATO, që ishte si të thuash fusha

e tij e punës për disa vite me radhë, ku raportet për këtë janë të panumërta. Ndërsa kontributi për revistën “Policimi dhe Siguria” është sinjifikativ të paktën në këto pesë vitet e fundit, sikurse janë: në maj 2019, koordinatori për Konferencën shkencore, “Siguria rrugore dhe përdoruesit e rrugës në Shqipëri”; më 12.2.2020, koordinatori i përgjithshëm i konferencës: “Krimi mjedisor, Siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”, ku ka publikuar edhe temën “Mjedisi dhe siguria parë në këndvështrimin e NATO-s; më 2021 ka publikuar: “NATO në operacionet e ndihmës emergjente në rastet e katastrofave natyrore”; më 2022, “Kontributi i policisë për emergjencat civile në tre dekadat e fundit”, që është përgatitur me bashkautorësi në kuadër të Konferencës së VIII shkencore ndërkombëtare “Siguria në komunitet në kontekstin e fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile” si dhe mjaft punime të tjera edhe në kuadër të doktoraturës.

Vlerësimi i një jete të jetuar me përkushtim për detyrën

Gjon Vorfi në karrierën e gjatë ushtarake, por edhe në Akademinë e Sigurisë ka pasur vlerësime në urdhra, medalje, dekorata e certifikata vlerësuese e mirënjohëse, por fakt është se ai nuk ka rendur kurrë pas tyre. Edhe pse nuk i ka kërkuar kurrë, ai është vlerësuar me dekorata nga Presidenti, MM, SHSHP-së, dhe nga NATO. Dy herë në Akademinë e Sigurisë në dy strukturat e fundit të saj ka qenë “Specialist në Sektorin e Botimeve në QKSH” dhe së fundi “Lektor/Redaktor shkencor në Sektorin e Botimeve dhe Informimit të Publikut në QKSHP”, por përpara se të flisnin dekoratat për Gjon Vorfin fliste puna. Gjon Vorfi me jetën e tij nuk shkroi një libër-jete, por ngriti një memorial mençurie të vlerave shembullore të ushtarakut dinjitoz. Në gjithë etapat e ngritjes, arsimimit, punës dhe veprimtarisë qytetare shoqërore, në të gjithë etapat e jetës së tij ndriçon më fort periudha e arsimimit dhe kualifikimit, që jo rrallë lidhen me “harron” ose e “thjeshton” vetëm në pak rreshta. Arsimimi elitë është pazgjidhshmërisht me veprimtarinë e përditshme të punës. Nuk ka dhe nuk mund të ketë progres pa lidhur teorinë me praktikën, librin me jetën, prandaj Gjon Vorfi e ka parë librin si një buqetë me dije që nuk shteron, duke e parë librin si të shenjtë. Ai ishte dhe mbeti gjithmonë solid në të gjitha nivelet e shkollimit dhe pati një karrierë të suksesshme elitare deri në funksionin e Drejtorit të Auditimit të NATO-s, funksione që rrallëkush i arrin dhe që i dha dritë e besueshmëri vendit të vogël, Shqipërisë në arenën e funksionarëve të sigurisë globale në Bruksel. Përvojën e gjatë në strukturat e sigurisë e mbrojtjes nuk e kurseu edhe në një front tjetër atë të strukturave policore. Për këtë arsye, më 10 maj 2023, Drejtori i QKSHP-së, Drejtori i Qendrës së Kërkimit shkencor dhe Projekteve, prof. asoc. dr. Xhavit Shala nëpërmjet rektorit të Akademisë së Sigurisë, prof. dr. Ilirjan Mandro i propozuan Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Muhamet Rrumbullaku, që Zoti Gjon Preng Vorfi me detyrë Lektor/Redaktor shkencor në Sektorin e Botimeve dhe Informimit të Publikut në QKSHP, të vlerësohet me “Certifikatë Mirënjohjeje”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me motivacion: “Për korrektesë të lartë në përmbushjen e të gjitha detyrave të ngarkuara në funksion të kërkimit dhe botimeve cilësore në Akademinë e Sigurisë si dhe në kryerjen në kohë e me përgjegjshmëri të çdo detyre të ngarkuar në funksion të përmbushjes së misionit në interes të Policisë së Shtetit”. Faktikisht vlerësimi për punën e përkushtimit të Gjon Vorfit ishte i argumentuar dhe saktësuar qartë, për të cilin në më shumë se katër dekada ka folur puna dhe përkushtimi i tij. Miratimi i “Mirënjohjes” është miratim i punës dhe përkushtimit në interes të kryerjes së misionit

në interes të përgatitjes dhe forcimit institucional edhe pse kontributi më cilësor dhe më i njohur i Gjon Vorfit është padyshim në punën përgatitore të pranimit të Shqipërisë në strukturën më të madhe botërore të sigurisë, NATO. Gjon Vorfi ka shkruar energjitet shumëvjeçare të pashtershme me gatishmëri, përkushtim e gatishmëri optimiste, duke marrë vazhdimisht përgjegjësi të shumta mbi supe, ku horizonti kulturor e profesional i jepte avantazhe në raport me lidshipin e gjerë ushtarak. Ai ka qenë mbështetës dhe kontribuues me mendim të pjekur dhe të thellë, analizues i kujdesshëm të vendit dhe rolit të Shqipërisë në organizmin e sigurisë globale si dhe ka drejtuar një ndër sektorët më të rëndësishëm në NATO, si drejtor i parë i Auditimit, që për Shqipërinë ka qenë një ndër kontributet e para dhe që ka marrë vlerësimet më të larta si nga spektri politik ashtu edhe ushtarak i NATO-s. Ndërkohë lidhja e bashkëpunimi ka qenë i gjerë edhe me studiues të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes të shtetit shqiptar, me studiues të fushës së studimeve historike, me anëtarë të Shoqatës së Historianëve Ushtarakë shqiptarë, me Qendrën Kërkimore Shkencore dhe Projekteve në Akademinë e Sigurisë, ku herë pas here edhe ka publikuar artikuj me vlerë që shkojnë tek lexuesi i gjerë, por veçanërisht tej studiues të fushës së studimeve të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Eksperienca e gjatë e punës në drejtim të sektorëve, degëve e drejtorive deri në NATO e kanë bërë Gjon Vorfin një personalitet që punon me qetësi dhe maturi, ku nën qetësinë dhe maturinë e tij qëndron edhe mençuria e punës me qetësi dhe pa bujë e pa lustra, pa kërkuar dhe të bëhet i zëshëm me pahir, pra është si kalliri plot, ku duke qenë një lexues i thekur dhe njeri smart, ka merituar respektin dhe vlerësimin e njerëzve kudo ku ka punuar brenda dhe jashtë vendit. Aristoteli thoshte: “Dinjiteti nuk matet me titujt që zotëron, por me vetëdijen që i meriton”, dhe Gjon Vorfi as i ka dashur dhe as i ka lakmuar titujt, sepse vetëdija e tij është merita reale e mençurisë dhe njerzillëkut të tij, që kolegët mendojnë e gjykojnë për veprimtarinë e tij. Shokët, miqtë dhe kolegët shpirtërisht i urojnë Gjon Vorfit: “Edhe njëqind vite lumturi e shëndet!”.



SHEMBULLIN E BABAIT PËR ATDHETARI DHE PËRKUSHTIM NDAJ ATDHUT, E NDOQI EDHE I BIRI, GJON VORFI QË NË FËMIJËRI DHE PËRGJATË GJITHË RRUGËTIMIT JETËSOR. GJON PRENG VORFI ËSHTË LINDUR, MË DATËN 27 GUSHT 1958, NË SUKAGJI TË LEZHËS, NË NJË AMBIENT FISNIK ATDHETAR, OXHAKUN E TË CILËVE NUK E KISHIN PËRKULUR PUSHTIMET DHE RREBESHET E KOHËS. BABAI I GJONIT, PRENG PJETËR VORFI KISHTE LINDUR MË 1920 NË SUKAGJI, FSHAT I LEZHËS ME RRETH 150 SHTËPI.



SHKOLLA DHE LIBRAT KANË QENË PASIONI I PËRHERSHËM I GJON VORFIT, EDHE PSE NË KOHËN E LIRË EDHE FIZARMONIKA, QË I JEPTË MUZIKALITET SHPIRTIT. PASIONANT PAS LEXIMIT, PËRFSHI EDHE GJUHËT E HUAJA ANGLISHT, FRËNGJISHT E ITALISHT, GJON VORFI E DINTE MIRË THËNIEN PROFETIKE ARISTOTELIANE SE, “RRËNJËT E SHKOLLIMIT JANË TË HIDHURA, POR FRYTET JANË TË ËMBLA”.



Forcat e Armatosura ju ofrojnë mjetet, trajnimin, sigurinë dhe kushtet për të ndjekur qëllimet tuaja. Të gjithë të rinjtë e të rejtat ftohen të

bëhen pjesë e Forcave të Armatosura për:

- t'i shërbyer me nder dhe krenari vendit Tuaj,
- një trajtim dinjitoz ekonomik,
- përvojë lidershipi,
- mundësi të ndryshme për vetëzhvillim (trajnim dhe arsimim i mëtejshëm) brenda dhe jashtë vendit.

Për informacione të tjera mbi kushtet dhe mënyrën e regjistrimit klikoni në faqen zyrtare të mëposhtme:

1. Rekrutimi si ushtar/detar aktiv:

info.qpr@aaf.mil.al

2. Rekrutimi si Oficer aktiv:

Faza e dytë e aplikimeve për studime në ciklin 3-vjeçar Bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura fillon në datat 15-17 Shtator 2023:

<https://www.tradoc.mil.al/njoftime/605-njoftim-per-hapjen-e-studimeve-ne-ciklin-e-pare-bachelor-viti-akademik-2023-2024>

• Kursi i Përgatitjes së Oficerit të Ri (pasuniversitar):

<https://www.mod.gov.al/karriera-2/1001-karriera-e-oficerit>

• Regjistrimi në 12 kuota studimi në Akademinë

Ushtarake "West Point" në SHBA, deri më 15 shtator:

<https://shorturl.at/HKL09>

Ju mirëpresim!